



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3781/ 12 prot.

Datë 05.03.2025

V E N D I M
Nr. 335/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fioorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 05.03.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me vlerësimin me pikë të propozimeve teknike të paraqitura nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Ndërtuesi 2014 SHPK & “Varaku E” SHPK, si dhe skualifikimin e këtij bashkimi operatorësh ekonomikë si ofertë anomalisht e ulët në procedurën e prokurimit “Procedurë e kufizuar (Marrëveshje Kuadër) - shërbime publike - mbi kufirin e lartë monetar - prokurim me mjete elektronike”, me REF-10945-06-24-2024, me objekt Loti 2 “Mirëmbajtje me performancë rruga “Koplik - Bogë, Bogë - Theth, Dedaj - Razëm” (gjatësia totale 67.3 km)”, me fond limit totale 329,552,917 (treqind e njëzet e nëntë milion e pesëqind e pesëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e shtatëmbëdhjetë) Lekë pa TVSH në Euro: 3,286,983.01 (tre milion e dyqind e tetëdhjetë gjashtë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tre pikë zero një) Euro pa TVSH, zhvilluar më datë 29.07.2024, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Ankimues:

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK me NIPT K87921701H dhe

L03425410B, me adresë: Rruga “Hasan Riza Pasha”, Shkodër.

Subjekt i interesuar:

Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Ndërtuesi 2014” Shpk (përfaqësues) me NIPT L46827004L dhe adresë: Shkoder, Rruga Daut Boriçi, zona kadastrale nr. 8594, numri i pasurisë 3/574+2-22, vëllimi 36, faqe 14 & “Varaku E” Shpk me NIPT J61902509S dhe adresë: Rruga Xhafzotaj-Durrës

Autoriteti Kontraktor:

Autoriteti Rrugor Shqiptar
Adresë Rruga “Sami Frashëri” Nr.33, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik, i ndryshuar.

I.2. Bashkimi i operatorëve ekonomikë ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

1.4. Bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. Ndërsa bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Ndertuesi 2014” Shpk & “Varaku E” Shpk, nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së Formularit të Paraqitjes së Argumentave pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 25.06.2024, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e kufizuar (Marrëveshje Kuadër) - shërbime publike - mbi kufirin e lartë monetar - prokurim me mjete elektronike”, me REF-10945-06-24-2024, me objekt Loti 2 “Mirëmbajtje me performancë rruga “Koplik - Bogë, Bogë - Theth, Dedaj - Razëm” (gjatësia totale 67.3 km)”, me fond limit totale 329,552,917 (treqind e njëzet e nëntë milion e pesëqind e pesëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e shtatëmbëdhjetë) Lekë pa TVSH në Euro: 3,286,983.01 (tre milion e dyqind e tetëdhjetë gjashtë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tre pikë zero një) Euro pa TVSH, zhvilluar më datë 29.07.2024, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

II.2. Në datë 29.07.2024 referuar sistemit elektronik të prokurimit (SPE) rezulton se autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën e parë të procedurës së mësipërme të prokurimit (shprehja e interesit), ku kanë shfaqur interes operatorët ekonomik si mëposhtë vijon:

BOE “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK.

BOE “Ndertuesi 2014” SHPK & “Varaku E” SHPK.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dhe sistemit të prokurimeve elektronike rezulton se në datën 29.08.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit si më poshtë vijon: :

BOE “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK
BOE “Ndertuesi 2014” SHPK & “Varaku E” SHPK

skualifikuar
kualifikuar

II.4. Në datën 29.08.2024, bashkimi i operatorëve ekonomik “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave në fazën e parë të shprehjes së interesit, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentat si vijon:

Bashkimi i Operatoreve ekonomik “Rroku GUEST & DEHA 2010” K87921701H L03425410B Skualifikohet, pasi nuk përmbush, kriteret e veçanta të kualifikimit, sipas parashikimeve të nenit 77, të LPP-se, si dhe kriteret e veçanta të kualifikimit të përcaktuara në dokumentat standarte të tenderit.

- Operatori ekonomik “Rroku GUEST” nuk përmbush kriterin 2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor (jo domosdoshmërisht në licencë), si më poshtë:

1 (një) Inxhinier Topograf

1 (një) Inxhinier Mekanik

Për secilin pjesëtar të stafit ndihmes të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune dhe CV. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin. Staf i kërkuar në pikën 2.3.5 nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruara në procedura të shpallura fituese. KVO gjatë kontrollit të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik “Rroku GUEST” konstaton se, në dokumentat e paraqitura për Ing. Mekanik ka pasaktësi. Nisur nga ky konstatim KVO bëri verifikime dhe rezultoi se Inxhinieri Mekanik i deklaruar nga Operatori ekonomik “Rroku GUEST” është i punësuar në Institucion shtetëror me kohë të plotë.

Operatori ekonomik “Rroku GUEST” në dokumentacionin e paraqitur për Borëpastruesen AJMT60, nga verifikimi i dokumentacionit vërehet se borëpastruesja nuk është APV sipas kërkesës në DST.

Operatori ekonomik “Rroku GUEST” në dokumentacionin e paraqitur për Autobot uji, nga verifikimi i dokumentacionit vërehet se në lejen e qarkullimit është rimorkio për transport mallrash, foto e paraqitur nuk tregon që është Autobot Uji.

II.5. Në datën 04.09.2024, nëpërmejt sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është dorëzuar ankesa me nr. A/2023/4520 dhe me nr. 2472/2024 prot, datë 04.09.2024, e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimmarrjes së autoritetit kontraktor mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike si dhe kundërshtimin e vendimmarrjes së autoritetit kontraktor mbi kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Ndertuesi 2014” SHPK & “Varaku E” SHPK.

II.6. Në datën 04.09.2024, nëpërmejt sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është dorëzuar ankesa me nr. A/2023/4520 dhe me nr. 2472/1 prot, datë 04.09.2024, e bashkimit të operatorëve ekonomikë “*Rroku Guest*” SHPK & “*Deha 2010*” SHPK, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimmarrjes së autoritetit kontraktor mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike si dhe kundërshtimin e vendimmarrjes së autoritetit kontraktor mbi kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “*Ndertuesi 2014*” SHPK & “*Varaku E*” SHPK.

II.7. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit 162/2020 “*Për prokurimin Publik*” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin për publikim Nr. 2472/3 prot., datë 04.09.2024 lidhur me arsyet e skualifikimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “*Rroku Guest*” SHPK & “*Deha 2010*” SHPK, që kundërshton me anë të ankesës me nr. 12472/2024 prot., datë 04.09.2024, dhe kriteret për të cilat bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues pretendon se nuk përmbushen nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “*Ndertuesi 2014*” SHPK & “*Varaku E*” SHPK.

II.8. Në datën 06.09.2024, nëpërmejt shërbimit postar pranë Komisionit të Prokurimit Publik është dorëzuar ankesa me nr. 2472/4 prot, datë 06.09.2024, e bashkimit të operatorëve ekonomikë “*Rroku Guest*” SHPK & “*Deha 2010*” SHPK, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimmarrjes së autoritetit kontraktor mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike si dhe kundërshtimin e vendimmarrjes së autoritetit kontraktor mbi kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “*Ndertuesi 2014*” SHPK & “*Varaku E*” SHPK.

II.9. Më datë 09.09.2024, bashkimi i operatori ekonomik “*Ndertuesi 2014*” SHPK & “*Varaku E*” SHPK ka paraqitur Formularin e Paraqitjes së Argumentave, nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave, të protokolluar pranë KKP-së, me nr. 2472/5 prot., datë 09.09.2024.

II.10. Në datën 13.09.2024, autoriteti kontraktor nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave, ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik shkresën “*Vendim mbi shqyrtimin e ankesës online nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Rroku Guest” Shpk & “Deha 2010” Shpk* me nr. Aplikimi A/2024/4521, të paraqitur në Autoritetin Kontraktor dhe në Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike” të protokolluar me tonën me nr. 2472/6 prot, datë 13.09.2024, si dhe shkresën me nr. 6747/2 prot., datë 17.09.2024, protokolluar me tonën me nr. 2472/7 prot., datë 20.09.2024 me objekt “*Shkresë Përcjellëse*”, (ardhur nëpërmjetë shërbimit postar) është depozituar nga autoriteti kontraktor akti i trajtimit të ankesës (nr. 6747/1 prot., datë 13.09.2024), nga verifikimi i të cilit konstatohet se autoriteti kontraktor ka vendosur mospranimin e ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “*Rroku Guest*” SHPK & “*Deha 2010*” SHPK.

II.11. Me shkresën nr. 2472/8 prot., datë 08.10.2024, me objekt “*Mbi detyrimin e autroitetit kontraktor për dhënie informacioni dhe dokumentacioni KPP-së lidhur me ankesën e bashkimit të*

operatorëve ekonomikë “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK, Komisioni Prokurimit Publik iu drejtuar autoritetit kontraktor Autoritetit Rrugor Shqiptar, duke i kërkuar informacion mbi dokumentacion e dorëzuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues.

II.12. Nëpërmjet shkresës me nr. 4211/21 prot., datë 15.10.2024, protokolluar me tonën me nr. 2472/9 prot., datë 17.10.2024 me objekt *“Dërgim dokumentacioni”* autoriteti kontraktor ka dorëzuar dokumnetacionin e kërkuar nga ana e Komisionit Prokurimit Publik ku citohet se *“Në vijim të shkresës tuaj nr. 2472/8 prot, datë 08.10.2024 “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni dhe dokumentacioni KPP-së lidhur me ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK”, lidhur me procedurën e prokurimit me objekt: “Loti 2 Mirëmbajtje me performancë rruga Koplik – Bogë -, Bogë – Theth, Dedaj – Razëm” (gjatësia totale 67.3 km), me fond limit 329,552,917 (treqind e njëzet e nëntë milion e pesëqind e pesëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e shtatëmbëdhjetë) Lekë pa TVSH në Euro: 3,286,983.01 (tre milion e dyqind e tetëdhjetë gjashtë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tre pikë zero një) Euro pa TVSH, me Numër Reference Ref-10945-06-24-2024, po ju dërgojmë dokumentacionin e njëhësuar me origjinalin, të dorëzuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK”.*

II.13. Me datë 31.10.2024, me Vendimin nr. 1541/2024 Komisioni Prokurimit Publik vendosi:

- 1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK në lidhje me skualifikimin e tyre nga procedura e prokurimit “Procedurë e kufizuar (Marrëveshje Kuadër) - shërbime publike - mbi kufirin e lartë monetar - prokurim me mjete elektronike”, me REF-10945-06-24-2024, me objekt Loti 2 “Mirëmbajtje me performancë rruga “Koplik - Bogë, Bogë - Theth, Dedaj - Razëm” (gjatësia totale 67.3 km)”, me fond limit totale 329,552,917 (treqind e njëzet e nëntë milion e pesëqind e pesëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e shtatëmbëdhjetë) Lekë pa TVSH në Euro: 3,286,983.01 (tre milion e dyqind e tetëdhjetë gjashtë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tre pikë zero një) Euro pa TVSH, zhvilluar më datë 29.07.2024, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.*
- 2. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK në lidhje me skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Ndertuesi 2014” SHPK & “Varaku E” SHPK nga procedura e prokurimit “Procedurë e kufizuar (Marrëveshje Kuadër) - shërbime publike - mbi kufirin e lartë monetar - prokurim me mjete elektronike”, me REF-10945-06-24-2024, me objekt Loti 2 “Mirëmbajtje me performancë rruga “Koplik - Bogë, Bogë - Theth, Dedaj - Razëm” (gjatësia totale 67.3 km)”, me fond limit totale 329,552,917 (treqind e njëzet e nëntë milion e pesëqind e pesëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e shtatëmbëdhjetë) Lekë pa TVSH në Euro: 3,286,983.01 (tre milion e dyqind e tetëdhjetë gjashtë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tre pikë zero një) Euro pa TVSH, zhvilluar më datë 29.07.2024, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.*

3. *Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK si dhe të korrigjojë shkëljet duke e kualifikuar këtë bashkim operatorësh ekonomikë.*
4. *Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga bashkimi operatorëve ekonomikë “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK.*
5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.14. Në datën 07.11.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomik pjesëmarrës mbi vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për ri-vlerësimin e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ku rezulton se BOE “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK, është i kualifikuar pas zbatimit të vendimit të KPP-së nr.1541/2024 datë 31.10.2024.

- | | |
|--|---------------|
| 1. BOE “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK | I Kualifikuar |
| 2. BOE “Ndërtuesi 2014” SHPK & “Varaku E” SHPK | I Kualifikuar |

II.15. Me shkresën nr. 6747/3 prot., datë 12.11.2024, protokolluar me tonën nr. 2472/14 prot., datë 15.11.2024, autoriteti kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar, informon se ka zbatuar vendimin Nr. 1541/2024, datë 31.10.2024, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e prokurimit “Procedurë e kufizuar (Marrëveshje Kuadër) - shërbime publike - mbi kufirin e lartë monetar - prokurim me mjete elektronike”, me REF-10945-06-24-2024, me objekt Loti 2 “Mirëmbajtje me performancë rruga “Koplik - Bogë, Bogë - Theth, Dedaj - Razëm” (gjatësia totale 67.3 km)”, me fond limit totale 329,552,917 (treqind e njëzet e nëntë milion e pesëqind e pesëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e shtatëmbëdhjetë) Lekë pa TVSH në Euro: 3,286,983.01 (tre milion e dyqind e tetëdhjetë gjashtë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tre pikë zero një) Euro pa TVSH, zhvilluar më datë 29.07.2024, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar. Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, Komisioni vëren se, autoriteti kontraktor nëpërmjet shkresës së mësipërcituar ka dërguar pranë Komisionit Prokurimit Publik praktikën për zbatimin e vendimit nr. 1551/2024 datë 31.10.2024, të KPP. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik dhe raport auditit KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës duke rishikuar statusin bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK ku nga i skualifikuar rezulton i kualifikuar. Ndaj në këto kushte, rezulton se autoriteti kontraktor ka marrë masat e nevojshme në zbatim të përcaktimeve të bëra në vendimin KPP 1541/2024, datë 31.10.2024 për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.16. Me datë 19.11.2024, me Vendimin nr. 1633/2024 Komisioni Prokurimit Publik vendosi:

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e kufizuar (Marrëveshje Kuadër) - shërbime publike - mbi kufirin e lartë monetar - prokurim me mjete elektronike”, me REF-10945-06-24-2024, me objekt Loti 2 “Mirëmbajtje me performancë rruga “Koplik - Bogë, Bogë - Theth, Dedaj - Razëm” (gjatësia totale 67.3 km)”, me fond limit totale 329,552,917 (treqind e njëzet e nëntë milion e pesëqind e pesëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e shtatëmbëdhjetë) Lekë pa TVSH në Euro: 3,286,983.01 (tre milion e dyqind e tetëdhjetë gjashtë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tre pikë zero një) Euro pa TVSH, zhvilluar më datë 29.07.2024, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar

2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

II.17. Në datë 25.11.2024 referuar sistemit elektronik të prokurimit (SPE) rezulton se autoriteti kontraktor ka dërguar ftesën për tender, për fazën e dytë, të procedurës së mësipërme të prokurimit duke iu drejtuar operatorëve ekonomikë të kualifikuar:

1. BOE “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK
2. BOE “Ndërtuesi 2014” SHPK & “Varaku E” SHPK

II.17.1. Në datë 11.12.2024 referuar sistemit elektronik të prokurimit (SPE) rezulton se autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën e dytë, të procedurës së mësipërme të prokurimit.

1. BOE “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK
2. BOE “Ndërtuesi 2014” SHPK & “Varaku E” SHPK

II.17.2. Në datë 13.12.2024 referuar sistemit elektronik të prokurimit (SPE) rezulton se autoriteti kontraktor ka kryer vlerësimin e Propozimeve ekonomiko-teknike dhe dhënien e pikëve operatorëve ekonomikë të kualifikuar në këtë fazë, të procedurës së mësipërme të prokurimit.

- | | | |
|--|--------|------|
| 1. BOE “Ndërtuesi 2014” SHPK & “Varaku E” SHPK | 297.00 | pikë |
| 2. BOE “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK | 295.20 | pikë |

II.17.3. Në datë 23.12.2024 autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “Formular Njoftim -Fituesi Paraprak”, për procedurën e prokurimit dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 90, datë 30.12.2024, ku është shpallur fitues bashkimi i operatorëve ekonomikë “Ndërtuesi 2014” SHPK & “Varaku E” SHPK

II.17.4. Në datën 27.12.2024, nëpërmejt sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është dorëzuar ankesa me nr. A/2024/4934 dhe me nr. 3791/2024 prot, datë 30.12.2024, e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimmarrjes së autoritetit kontraktor në lidhje me vlerësimin me pikë të propozimeve teknike të ofertuesve në këtë procedurë prokurimi si dhe skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë Ndërtuesi 2014” SHPK & “Varaku E” SHPK si ofertë anomalisht e ulët me pretendimet si më poshtë vijon:

Nga Autoriteti Kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar kemi marrë këtë përgjigje për argumentimin e vlerësimit me pikë për të dy operatorët ekonomik: PROCESVERBAL NR. 4, DATË 18.12.2024 MBI VLERËSIMIN E PROPOZIMIT EKONOMIKO-TEKNIK Objekti i kontratës / marrëveshjes kuadër: “Kontrata punimesh dhe mirëmbajtje të rrugëve nacionale (kontratat e mirëmbajtjes), Rajoni Verior Shkodër” (ndarë në 15 lote), “Procedurë e kufizuar (marrëveshje kuadër) - shërbime publike - mbi kufirin e lartë monetar - prokurim me mjete elektronike” me fond limit të përgjithshëm 2,966,127,447 (dy miliardë e nëntëqind e gjashtëdhjetë gjashtë milion e njëqind e njëzet e shtatë mijë e katërqind e dyzet e shtatë) lekë pa TVSH. Në Euro: 29,584,355.14 (njëzet e nëntë milion e pesëqind e tetëdhjetë e katër mijë e treqind e pesëdhjetë e pesë pikë katërmëdhjetë) Euro pa TVSH, me REF-10941-06-24-2024. Objekti i prokurimit është Loti 2: “Mirëmbajtje me performancë rruga Koplik - Bogë, Bogë - Theth, Dedaj – Razëm” (gjatësia totale 67.3 km), me vlerë totale 329,552,917 (treqind e njëzet e nëntë milion e pesëqind e pesëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e shtatëmbëdhjetë) lekë pa TVSH NË Euro: 3,286,983.01 (tre milion e dyqind e tetëdhjetë gjashtë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tre pikë zero një) Euro pa TVSH, me REF-10945-06-24-2024.

Komisioni i vlerësimit të Ofertave i përcaktuar në urdhrin Nr. 232, datë 26.07.2024 “Për Ngritjen e Komisionit të vlerësimit të Ofertave”, në prani edhe të personit përgjegjës për procedurën, përcaktuar në urdhrin e prokurimit Nr. 156, datë 05.06.2024 u mblodh në Autoritetin Rrugor Shqiptar, sot, më datë 03.10.2024, për vlerësimin e propozimit ekonomik-teknik dhe dhënien e pikëve operatorëve ekonomikë, për objektin e mësipërm.

Më datë 25.11.2024 Autoriteti Kontraktor ka ftuar nëpërmjet sistemit për paraqitjen e ofertave ekonomike, operatorët e kualifikuar në fazën e parë, si më poshtë:

- | | |
|--------------------------------------|-------------------------|
| 1- BOE “Ndertuesi 2014” & “Varaku E” | L46827004L / J61902509S |
| 2- BOE “Rroku Guest” & “Deha 2010” | K87921701H / L03425410B |

Operatorët ekonomikë i janë përgjigjur ftesës për ofertë, konkretisht:

- | | |
|--------------------------------------|-----------------------------|
| 1- BOE “Ndertuesi 2014” & “Varaku E” | 243,533,743.21 lekë pa TVSH |
| 2- BOE “Rroku Guest” & “Deha 2010” | 247,180,684.24 lekë pa TVSH |

Në mbështetje të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 për Mirarimin e Rregullave të Prokurimit Publikë (i ndryshuar), Neni 82 ishqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave, pika 4 citohet: Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me cmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme: - Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur; - Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së. Komisioni i vlerësimit të Ofertave konstatoi se oferta e paraqitur nga BOE “Ndertuesi 2014” & “Varaku E” është anomalisht e ulët. Si rezultat i këtij fakti, KVO bazuar në Nenin 93 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) i ka kërkuar BOE “Ndertuesi 2014” & “Varaku E” të paraqesë me shkrim brenda tri ditëve pune shpjegime për cmimin ose kostot e propozuara në ofertë.

Më datë 16.12.2024 BOE “Ndertuesi 2014” & “Varaku E” ka paraqitur argumentimin ekonomik të ofertës së tyre, duke analizuar edhe cmimet për secilin zë. KVO vendosi që oferta ekonomike e BOE është e justifikuar plotësisht me analizën e cmimeve të paraqitur.

Në dokumentet standarde të tenderit janë përcaktuar kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto X Sipas rëndësisë:

Cmimi pikët	[0 - 60]
Përvoja në shërbime të ngjashme pikët	[0 - 20]
Cilësia pikët	[0 - 15]
Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social pikët	[0 – 5]

Metodologjia e vlerësimit për ofertën ekonomikisht më të favorshme bazuar në kosto Kriteret e vlerësimit:

Të gjitha kriteret vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në cdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë më pak se 60 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100. Autoriteti kontraktor do të vlerësojë pikët për kriteret me vlerësim relativ (kriteri 1) e rrumbullakosur me dy shifra pas presjes dhjetore (0,00) ndërsa për kriteret me vlerësim absolut (kriteri 2.a/b, 3, 4.a/b) do të vlerësohen me numra të plotë (0).

Kriteri:

1. Cmimi

[0 - 60 pikë]

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

$$Pk1 = Vmink1 \times Pmaxk1 / Ok1$$

Pk1 pikët e kriterit që vlerësohet

Vmink1 Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet

Pmaxk1 pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok1 Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

2. Përvoja në shërbime të ngjashme

[0 - 20 pikë]

Operatori ekonomik duhet të përshkruaj përvojën e shërbimeve të ngjashme të realizuara në formën e CV, shoqëruar me vërtetim punimesh, të kryera në 10 vitet e fundit. Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

A. Përvojë e ngjashme, punime për ndërtim rrugësh / rikonstrukcion rruge [0 - 5 pikë]

B. Përvojë e ngjashme mirëmbajtje rrugësh [0 - 15 pikë]

3. Cilësia

[0 - 15 pikë]

Treguesit dhe analiza cilësore në punë duke përcaktuar elementet e saj por pa u limituar në cilësinë e propozimit teknik për sa i përket metodave të përdorura, personelit kryesor, disponueshmërisë së pajisjeve kryesore, organizimi i stafit, siguria, sigurimit të cilësisë, planit të mobilizimit, garancia e punimeve të rehabilitimit dhe Ádo aktiviteti tjetër.

4. Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social

[0 - 5 pikë]

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një metodologji të qartë për minimizimin e ndikimit në mjedis të veprës, si dhe propozimet e tij për menaxhimin e riskut mjedisor dhe social (sipas vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS)). Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nën-kriteri:

A. Propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike (miqësore me mjedisin) / të ricikluara / eficiente / materiale që minimizojnë ndikimin mjedisor. Përdorimi i makinerive / pajisjeve ekologjike. Hartimi i një plan propozimi të menaxhimit dhe kontrollit të minimizimit efekteve mjedisore. [0 - 3 pikë]

B. Propozime konkrete për përmirësime të ekonomisë lokale të zonës, ku kryhet shërbimi si një iniciativë sociale e ofertuesit nëpërmjet punësimeve.

[0 - 2 pikë]

*Shënim: Të gjithë dokumentacionet me propozime të përshkruara nga operatori ekonomik në plotësim të kritereve të mësipërme të vlerësimit do të reflektojnë kushtet e kontratës (për të përfshirë propozimin konkret), duke mos implikuar asnjë kosto shtesë mbi vlerën e ofertuar për realizimin e punimeve të kontratës (sipas shtojcës nr. 1), për shkak të propozimeve të mësipërme.

Komisioni i vlerësimit të Ofertave bëri kontrollin për veprimet aritmetike të ofertave dhe konstatoi se ofertat janë pa gabime aritmetike dhe në formën e kërkuar. Për bashkimin e operatorëve ekonomikë të kualifikuar, vlerësimi me pikë është si më poshtë:

Pikët për BOE “Ndertuesi 2014” & “Varaku E” të shprehura në përqindje (%), sipas sistemit.

Anëtari i KVO-së	Oferta ekonomike			pikët për cmimin
Në %				
Pikët për përvojën në shërbime të ngjashme				
Në %				
Pikët për cilësinë				
Në %				
Pikët për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social				
Në %				
Total				
243,533,743.21	100%	100%	100%	80%
243,533,743.21	100%	100%	100%	80%
243,533,743.21	100%	100%	100%	80%

Pikët totale të marra sipas sistemit elektronik 297.00

Pikët për BOE “Ndertuesi 2014” & “Varaku E” të shprehura në pikë sipas formulës.

Anëtari i KVO	Oferta ekonomike				pikët për cmimin
(0-60) pikët për përvojën në shërbime të ngjashme					
(0-20) pikët për cilësinë					
(0-15) pikët për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social					
(0-5) Total.					
243,533,743.21	60.00	20.00	15.00	4.00	99.00
243,533,743.21	60.00	20.00	15.00	4.00	99.00
243,533,743.21	60.00	20.00	15.00	4.00	99.00

Pikët totale të marra sipas formulës: 297.00

Pikët për BOE “Rroku Guest” & “Deha 2010” të shprehura në përqindje (%), sipas sistemit.

Anëtari i KVO-së	Oferta ekonomike			pikët për cmimin
Në %				
Pikët për përvojën në shërbime të ngjashme				
Në %				

Pikët për cilësinë

Në %

Pikët për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social

Në %

Total

247,180,684.24	99%	100%	100%	80%
247,180,684.24	99%	100%	100%	80%
247,180,684.24	99%	100%	100%	80%

Pikët totale të marra sipas sistemit elektronik 295.20

Pikët për BOE “Rroku Guest” & “Deha 2010” të shprehura në pikë sipas formulës.

Anëtar i KVO

Oferta ekonomike

pikët për cmimin

(0-60) pikët për përvojën në shërbime të ngjashme

(0-20) pikët për cilësinë

(0-15) pikët për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social

(0-5) Total

247,180,684.24	59.11	20.00	15.00	4.00	98.11
247,180,684.24	59.11	20.00	15.00	4.00	98.11
247,180,684.24	59.11	20.00	15.00	4.00	98.11

Pikët totale të marra sipas formulës: 294.34

Renditja përfundimtare është:

<i>Nr.</i>	<i>Operatori ekonomik</i>	<i>pikët</i>	<i>Oferta Ekonomike</i>	<i>Sipas sistemit</i>	<i>pikët sipas formulës</i>
1	BOE “Ndertuesi 2014” & “Varaku E”	243,533,743.21		297,00	297,00
2	BOE “Rroku Guest” & “Deha 2010”	247,180,684.24		295,20	294,34

Komisioni i vlerësimit të Ofertave në zbatim të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), autorizon personin përgjegjës për mbylljen e fazës së vlerësimit dhe vijimin me Njoftimin e Fituesit Paraprak.

Sipas dokumentave të Paraqitura nga K.V.O, BOE “Rroku Guest” & “Deha 2010” nuk arrijnë të dalin në konkluzione të sakta lidhur me mënyrën e vlerësimit. Procesverbali i munguar i argumentimit të pikëve, si dokument DUHEJ paraqitur sipas gjithë të drejtave të operatorit që merr pjesë. Gjendur në këtë situatë, BOE “Rroku Guest” & “Deha 2010” vlerëson se ka gabime të qenësishme në vlerësimin midis 2 operatoreve pjesmarrës. Në Procesin e vlerësimit, merret në konsideratë jo vetëm oferta ekonomike e paraqitur, por edhe gjithë detajet metodologjike, që ofrojnë garanci në zbatimin e kësaj kontrate. Duke mos patur asnjë të dhënë mbi ofertuesin tjetër

pjesmarrës, ne shohim me vend të theksojmë se, gjithë puna dhe qëllimi i vlerësimit me pikë bazuar në propozimin tekniko - ekonomike, shikohet dhe vlerësohet në Analizë KRAHASIMORE midis 2 ofertuesve për pjesën teknike që ofrohet. Oferta ekonomike ka peshën e saj në vlerën 60% dhe lehtësisht me anë të një formule del në konkluzion (krahaskimor) të vlerësimit me pikë. Nga ana tjetër oferta teknike, e cila mban peshën prej 40% nuk është vlerësuar në linjë me një llogjikë të qëndrueshme mbi cilin operator peshon teknikisht zgjidhja me e qëndrueshme, qoftë metodologji apo cilësi apo si dhe cfarë operatori sjell si risi në kantier, për të cilën BOE “Rroku Guest” & “Deha 2010” ka qënë shumë i kujdesshëm ta theksojë në cdo dokument paraqitur.

Nga sa më sipër, biem ndesh me vlerësimin e barabartë të K.V.O për 2 grup-pikëzimet:

1 - CILËSIA,

2 - PROPOZIMET PER ULJEN E NDIKIMIT NË MJEDIS DHE NDIKIMIN SOCIAL,

Duke na lënë vënd për të diskutuar nëse ky pikëzim i barabartë tregon se si BOE “Rroku Guest” & “Deha 2010” si pjesmarrësi tjetër BOE “Ndertuesi 2014” & “Varaku E” ka ofertuar ekzaktesisht të njëjtin volum përkushtimi në zgjidhjen cilësore dhe jo vetëm, të kësaj kontrate. Në vijim, BOE “Rroku Guest” & “Deha 2010” kërkon ri-vlerësim të pikëzimit për 2 komponentët si më sipër përmendur, duke marrë në konsideratë se secili nën zë për të lartpërmendurat ka një shpërndarje pikësh të dedikuar.

Së pari referuar vlerësimit me pikë nga K.V.O.

PIKËT PËR CILËSINË (0-15)

Referuar dokumenteve standarde të tenderit për cilësinë është kërkuar:

Treguesit dhe analiza cilësore në punë duke përcaktuar elementet e saj por pa u limituar në cilësinë e propozimit teknik për sa i përket

Metodave të përdorura,

Personelit kryesor,

Disponueshmërisë së pajisjeve kryesore,

Organizimi i stafit, Siguria,

Sigurimit të cilësisë,

Planit të mobilizimit,

Garancia e punimeve te rehabilitimit dhe cdo aktiviteti tjetër.

Për të plotësuar këtë kriter për pikëzim, ne si operator ekonomik kemi dorëzuar në S.P.E dokumentin:

3.0 CILËSIA (24 faqe e ndarë me kapituj sipas kërkesës së DST për cilësinë)

3.1 Plani manuali cilësisë për shërbimet e mirëmbajtjes (12 faqe)

3.2 Plani operacional i mirëmbajtjes LOTI 2 (67 faqe)

3.3 Manuali menaxhimit të trafikut mirëmbajtja (46 faqe)

3.4 Manuali jetës dhe shëndetit mirëmbajtja (73 faqe)

3.5 Deklaratë për cilësinë (1 faqe)

3.6 Godina e mirëmbajtjes (10 faqe, dokumentacioni i pronësisë së godinës)

Referuar këtyre dokumenteve të cilat janë dorëzuar në S.P.E ku do t'i bashkangjiten këtij ankimi, po ti perifrazojmë, ne kemi marrë përsipër të kryejmë investime shtesë për të përmirësuar kushtet teknike në raport me metodat, personelin, disponueshmerine e pajisjeve, organizimit të stafit, sigurisë, sigurimit të cilësisë si dhe planit të mobilizimit dhe konkretisht:

1. Kemi ofruar NDËRTIMIN DHE KRIJIMIN E GODINËS SË MIRËMBAJTJES (faqe 21,22 dhe 23, dokumenti 3.0 CILËSIA) që do jetë në funksion të projektit duke krijuar akses në përmirësimin disponueshmërisë së makinerive, organizimin e stafin, planit të mobilizimit, sigurimit të cilësisë dhe mobilitetit të personelit kryesor. Në dokumentin 3.0 CILËSIA, kemi paraqitur saktësisht gjendjen e godinës dhe pronës, me fotot përkatëse si dhe vendndodhjen. Gjithashtu në Dokumentin 3.0 CILËSIA gjendet edhe projekti se si do të rivitalizohet kjo pronë për tu vënë në dispozicion të projektit. Theksojmë që kjo pronë është në pronësi të administratores dhe bashkëshortit të saj, pasi jetojnë në Bogë dhe kanë ofruar një nga pronat për ta vënë në funksion të projektit për përmirësimin e ofertës tekniko ñ ekonomike në këtë procedurë.

2. Kemi ofruar ndërtimin e kaponit për mbajtjen e makinerive dhe materialeve që do shërbejnë për përmirësimin e kushteve teknike të rrugës, kaponi do ndërtohet ngjitur me godinën e mirëmbajtjes. Ai do të shërbejë për mobilizimin e makinerive si dhe e materialeve të tjera të nevojshme për kryerjen e proceseve ndërtimore sidomos për vendosjen e kripës në rastet e muajve të dimrit.

3. Kemi ofruar instalimin e kamerave në katër pika përgjatë aksit, më saktësisht në km 11.6 në aksin Dedaj - Razem, në km 4.6 të aksit Bogë - Theth, në km 11.5 të aksit Boge - Theth si dhe në km 24.5 të aksit Boge - Theth. Në të gjitha këto pika do të dislokohen grupet përkatëse në rastin e emergjencave dimërore. Të gjitha këto kamera do të kenë qendrën e tyre tek godina e mirëmbajtjes ku do të vendoset edhe stafi përkatës për menaxhimin e situatave të emergjencave. Kjo metodë do bëjë që të rrisi sigurinë e mirëmbajtjes në kohë reale për njoftimin e udhëtarëve dhe përgatitjen e masave për parandalimin e cdo lloj avarie.

4. Kemi projektuar instalimin e tabelave treguese elektronike në kilometrin 4.6 te aksit Bogë - Theth do vendosim një tabelë sinjalizuese (elektronike) për lajmërimin e mjeteve që do lëvizin në aks për kohën dhe gjendjen e rrugës si dhe në çfarë niveli kalueshmërie do jetë rruga dhe sa kohë mund të dojë për zhbllokimin e plotë të trasesë së rrugës për mjetet e vogla. Në kilometrin 28.7 të aksit Koplik - Bogë, do vendosim një tabelë sinjalizuese (elektronike) për lajmërimin e mjeteve që do lëvizin në aks për kohën dhe gjendjen e rrugës, kjo tabelë do vendoset tek godina që do rikonstruktohet. Në kilometrin 0 të aksit Dedaj - Razëm do vendosim një tabelë sinjalizuese (elektronike) për lajmërimin e mjeteve që do lëvizin në aks për kohën dhe gjendjen e rrugës si dhe në çfare niveli kalueshmërie do jetë rruga dhe sa kohë mund të dojë për zhbllokimin e plote të trasesë së rrugës për mjetet e vogla. Në kilometrin 0 të aksit Theth - Bogë do vendosim një tabelë

sinjalizuese (elektronike) për lajmërimin e mjeteve që do lëvizin në aks për kohen dhe gjëndjen e rrugës si dhe në cfarë niveli kalueshmërie do jetë rruga dhe sa kohë mund të dojë për zhbllokimin e plotë të trasesë së rrugës, në rastet e orteqeve. Gjë që ndikon edhe në menaxhimin e turizmit dhe per bizneset që janë në zonë.

5. Kemi ofruar gjithashtu edhe pastrimin e dëborës dhe përmirësimin rrugor në disa prej akseve të brëndshme të fshatrave të cilat i prek ky projekt, kjo për të përmirësuar jetën për banorët si dhe për bizneset që zhvillojnë turizmin në këto zona.

Keto jane disa nga propozimet kryesore të cilat janë shtesë në raport me specifikimet teknike dhe raportin teknik të projektit, ku referuar edhe shënimit të D.S.T: Të gjithë dokumentacionet me propozime të përshkruara nga operatori ekonomik në plotësim të kriterëve të mësipërme të vlerësimit do të reflektojë kushtet e kontratës (për të përfshirë propozimin konkret), duke mos implikuar asnjë kosto shtesë mbi vlerën e ofertuar për realizimin e punimeve të kontratës (sipas shtojcës nr. 1), për shkak të propozimeve të mësipërme. Pra thënë qartë të gjitha këto propozime do të jenë në koston e kontraktorit (ofertën teknike) i cili për të përmirësuar kushtet teknike dhe vizive ka bërë këto zotime për përmirësimin e kushteve të shërbimit (referuar edhe Dokumentit 3.5 deklaratë për cilësinë).

Kostot e propozimit teknik të BOE “Rroku Guest” & “Deha 2010” janë përafërsisht:

Qeraja për godinen e mirëmbajtjes 48 muaj	1 200 000.00
Rikonstruksioni i godinës së mirëmbajtjes	2 010 000.00
Ndërtimi i kaponit për makineritë dhe materialet	5 400 000.00
Staf i monitorimit për muajt pa ngarkesë	2 880 000.00
Staf i monitorimit për muajt me ngarkesë	4 320 000.00
Blerja e Kamerave dhe sensorëve	280 000.00
Kosto të mirëmbajtjes dhe operimit	576 000.00
Blerjes e tabelave elektronike	340 000.00
Kosto të mirëmbajtjes dhe operimit	384 000.00
TOTALI I INVESTIMIT PËR CILËSINË :	17 389 000 LEKË

Gjithashtu në DST janë kërkuar 3 borë-pastruese, që ne i kemi në pronësi aktualisht, por për përmirësimin e cilësisë jemi zotuar të përdorim edhe 3 borëpastruese shtesë që do blihen për të plotësuar zotimin për hapjen edhe të akseve dytësore në fshatra, për përmirësimin e turizmit, sidomos gjatë dimrit.

Duke marrë në konsideratë faktin se BOE “Rroku Guest” & “Deha 2010” ka ofruar një garanci punimesh prej 7% të vlerës së punimeve të rehabilitimit për certifikim punimesh, si dhe plot 36 muaj nga momenti i certifikimit të përkohshëm të Punimeve të Rehabilitimit, si dhe duke qënë se vlerësimi nga KVO, mbetet i barabartë për të dy operatorët, **na lind pyetja nëse pjesëmarrësi tjetër ka ofertuar njësoj si ne.** Në mangësi të dokumenteve për kontrollin sic duhet të ishte në Procesverbal, ne shohim sërish se ka mangësi në mënyrën e vlerësimit i cili gjithmonë duhet të

mbetet brenda një llogjike të qëndrueshme krahasimore midis 2 operatorëve, dhe jo vetëm kualifikuese.

Referuar edhe vendimit të KPP Nr. 562/2020 datë 09.12.2020 ku shprehimisht thuhet se: “komisioni gjykon se procesi i pikëzimit duhet bërë në përputhje dhe në proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga ofertuesit”.

Prandaj procesi i pikëzimit në procedurat që kanë si kriter të përzgjedhjes së fituesit ofertën ekonomisht më të favorshme, duhet të bëhet në përputhje dhe në proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga secili ofertues, për këtë kemi bindjen që operatori tjetër konkurses nuk ka ofruar asgjë në raport me përmirësimin e cilësisë duke i'u referuar përmirësimit të kushteve teknike në raport me metodat, personelin, disponueshmërinë e pajisjeve, organizimit të stafit, sigurisë, sigurimit të cilësisë si dhe planit të mobilizimit, për këtë arsye nuk mund të jemi të pikëzuar njësoj.

Në vijim, BOE “Rroku Guest” & “Deha 2010” kërkon ri-vlerësim (ku sic krahasohet oferta ekonomike me formulë, të krahasohet edhe oferta teknike mes operatorëve) të pikëzimit për komponentin si më sipër përmendur, duke marrë në konsideratë se secili nën zë për të lart përmendurat ka një shpërndarje pikësh të dedikuar.

Pikët për propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social [0 - 5 pikë]

Referuar Dokumenteve standarde të tenderit për cilësinë është kërkuar: Operatori ekonomik duhet të paraqesë një metodologji të qartë për minimizimin e ndikimit në mjedis të veprës, si dhe propozimet e tij për menaxhimin e riskut mjedisor dhe social (sipas vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS)). Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nën-kriteri:

A. Propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike (miqësore me mjedisin) / të ricikluara / eficiente / materiale që minimizojnë ndikimin mjedisor. Përdorimi i makinerive / pajisjeve ekologjike. Hartimi i një plan propozimi të menaxhimit dhe kontrollit të minimizimit efekteve mjedisore. [0 - 3 pikë]

B. Propozime konkrete për përmirësime të ekonomisë lokale të zonës, ku kryhet shërbimi si një iniciativë sociale e ofertuesit nëpërmjet punësimeve. [0 - 2 pikë]

Për të plotësuar këtë kriter për pikëzim, BOE “Rroku Guest” & “Deha 2010” ka dorëzuar në S.P.E dokumentin:

4.0 NDIKIMI NE MJEDIS E SOCIAL (14 faqe)

4.1 Plani i menaxhimit Mjedisor dhe Social LOTI 2 (27 faqe)

4.2 NDIKIMI SOCIAL CERT PERSONALE (9 faqe)

4.3 MAKINE ELEKTRIKE PER NDIKIMIN NE MJEDIS (2 faqe)

Ne jemi vlerësuar me 4 pikë në këtë kriter, pa e ndarë se sa pikë kemi marrë në nënkriteret sipas ndarjes së DST. Ne mendojmë që propozimi jonë meriton 5 pikë të plota. Referuar dokumentit 4.0 Ndikimi në mjedis e social, ne kemi përshkruar dhe marrë të gjitha masat e nevojshme dhe kemi dhënë propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike (miqësore me mjedisin), të ricikluara dhe eficiente apo materiale që minimizojnë ndikimin mjedisor, kjo referuar edhe dokumentit 4.1 Plani i menaxhimit mjedisor dhe social. Gjithashtu kemi propozuar edhe hartuar planin për menaxhimin dhe kontrollin e efekteve mjedisore, duke ofruar edhe makineri elektrike në flotën tonë sipas dokumentit 4.3 MAKINË ELEKTRIKE PËR NDIKIMIN NË MJEDIS. Për këtë arsye ne meritojmë pikët maksimale dhe referuar edhe konkurentit, mendojmë që ai nuk e ka plotësuar kriterin konform kërkesave të D.S.T.

Gjithashtu saj përket pikës b, për propozimet konkrete për përmirësimin e ekonomisë lokale ku kryhet shërbimi nëpërmjet punësimeve mendojmë që BOE “Rroku Guest” sh.p.k & “Deha 2010” shpk duhej të vlerësohej me pikët maksimale pasi administratori dhe një pjesë e mirë e punonjësve, deklaruar edhe me dokumentin 4.2 NDIKIMI SOCIAL CERT PERSONALE, vërtetohet që punonjësit e vetdeklaruar në fazën e parë në formularin e vetdeklarimit, janë banorë të zonës që preket nga aksi i projektit. Ndërkohë kompania tjetër maksimumi mund të ketë 1-2 punonjës të vetdeklaruar të zonës. Për këtë arsye duhet të ketë diferencim në pikë dhe ne të marrim pikët maksimale.

Në vijim, BOE “Rroku Guest” & “Deha 2010” kërkon rivlerësim (ku sic krahasohet oferta ekonomike me formulë, të krahasohet edhe oferta teknike mes operatorëve) të pikëzimit për komponentin si më sipër përmendur, duke marrë në konsideratë se secili nën zë për të lart përmendurat ka një shpërndarje pikësh të dedikuar.

Së dyti duke u bazuar në Procesverbalin Nr. 4, datë 18.12.2024 mbi vlerësimin e propozimit ekonomik - teknik të dërguar në rrugë elektronike ku shprehet se ju keni pranuar një ofertë anomalisht të ulët, ne kemi kërkuar vazhdimisht proces - verbalin e pranimit të kësaj oferte anomalisht të ulët duke i'u referuar analizës së kostove të paraqitura nga operatori ekonomik konkurues i cili ka dhënë kete oferte. Kjo pasi kemi indicie që jemi në kushtet kur oferta anomalisht e ulët nuk duhet pranuar nga Autoriteti Kontraktor, pasi nuk plotëson 5 kushtet referuar Nenit 93 të ligjit të prokurimit publik kur: Oferta anomalisht e ulët. Kemi indicie dhe dyshime që oferta e shpallur fituese nuk respekton detyrimet e zbatueshme nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në FUSHËN SOCIALE DHE TË PUNËS e të akteve të tjera, më konkretisht nuk plotëson V.K.M Nr. 113, datë 1.3.2023 “PËR PËRCAKTIMIN E PAGËS MINIMALE NË SHKALLË VËNDI”, **ku paga minimale neto orare duhet të jetë 229.9 lekë/orë dhe bruto 301.63 lekë/orë**. Gjithashtu duhet vlerësuar që një pjesë e madhe e punimeve të rehabilitimit kërkojnë punëtorë të specializuar dhe jo punëtorë të thjeshtë. **Rikujtojmë që struktura e preventivit të rehabilitimeve në raport me orët e punës nuk duhet ndryshuar pasi konsiderohet ndërhyrje në ofertë**. Gjithashtu bazuar në nenin 93 të ligjit të prokurimit publik pika 2.a anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të

ofruara ose të metodës së ndërtimit; Operatori ekonomik ofertues do duhej të dorëzonte faturat tatimore për të justifikuar cmimet e materialeve dhe arsyet pse i ka ato cmime aq të ulëta, nëse nuk ka dorëzuar FATURA TATIMORE, dhe jo oferta dhe dokumente të tjera që nuk kanë vlerë, nuk plotësohet kushti 2.a i nenit 93 të ligjit të Prokurimit Publik. Për këtë arsye ne kërkojmë skualifikimin e ofertës së B.O.E “Ndertuesi 2014” shpk & “Varaku E” shpk si anomalisht e ulët e cila nuk i plotëson 5 kushtet referuar nenit 93 të Ligjit të Prokurimit Publik.

II.17.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 3781/2 prot., datë 30.12.2024 ku u konstatua se, objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimmarrjes së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për vlerësimin me pikë të propozimeve teknike të paraqitura nga bashkimi operatorëve ekonomikë “Ndertuesi 2014” SHPK & “Varaku E” SHPK, si dhe skualifikimin e këtij bashkimi operatorësh ekonomikë si ofertë anomalisht e ulët në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.17.6. Më datë 06.01.2025, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Rroku Gust” SHPK & “Deha 2010” SHPK ka dërguar “Formular ankesë”, nëpërmjet shërbimit postar, protokolluar pranë Komisionit Prokurimit Publik ankesa me nr. 3781/3, datë 06.01.2025.

II.17.7. Më datë 07.01.2025, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Ndertuesi 2014” SHPK & “Varaku E” SHPK, ka depozituar pranë KPP-së, “Formular Argumentash”, nëpërmjet postës elektronike, protokolluar me nr. 3781/4, datë 07.01.2025.

II.17.8. Më datë 09.01.2025, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Ndertuesi 2014” SHPK & “Varaku E” SHPK, ka depozituar pranë KPP-së, “Formular Argumentash”, nëpërmjet shërbimit postar, protokolluar me nr. 3781/5, datë 09.01.2025.

II.17.9. Me shkresën nr. 130/1 prot, datë 09.01.2025, protokolluar me tonën me nr. 3781/6 prot, datë 13.01.2025, autoriteti kontraktor, ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik shkresën nr. 130 prot, datë 08.01.2025 “Vendim mbi shqyrtimin e ankesës online nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Rroku Gust” SHPK & “Deha 2010” SHPK me nr. Aplikimi A/2024/4934, të paraqitur në Sistemin e Ankesave Elektronike”, ku informon lidhur me vendimmarrjen e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës për trajtimin e ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, në të cilën konstatohet, se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës e vendosur mospranimin e ankesës të bashkimit të operatorëve ekonomik ankimues me argumentat si vijon:

III. Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave

Se pari, lidhur me pretendimin mbi rivleresimin me pike per kategorite:

- | | |
|--|--------------|
| 1. Cilesia | (0-15 pikë) |
| 2. Propozimet per uljen e ndikimit ne mjedis dhe ndikimit social | (0-5 pikë) |

Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave nga shqyrtimi i dokumentacionit veren se nga Komisioni i Vlerësimit te Ofertave piket e dhena janë:

Piket per cilesine

BOE “Rroku Guest” & “Deha 2010” SHPK	15 pike
BOE “Ndërtuesi 2014” & “Varaku E” SHPK	15 pike

Pikët per uljen e ndikimit ne mjedis dhe ndikimin social

BOE “Rroku Guest” & “Deha 2010” SHPK	4 pike
BOE “Ndërtuesi 2014” & “Varaku E” SHPK	4 pike

Per plotesimin e ketij kriteri nga te dy operatorët pjesmarrës ne kete procedure jane paraqitur materialet e nevojshme referuar dokumentave standarte te tenderit ku konkretisht edhe nga bashkimi i operatoreve ekonomik “Ndërtuesi 2014” & “Varaku E” jane paraqitur materialet si me poshte:

- *Plani i sigurimit te cilësise ne mirembajtje (10 faqe)*
- *Plani operacional i mirembajtjes dhe disponeshmerise (57 faqe)*
- *Manuali i menaxhimit të trafikut dhe emergjences (35 faqe)*
- *Manuali i mbrojtjes se jetes dhe shëndetit (37 faqe)*
- *Vleresimi i riskut te punimeve të mirembajtjes (26 faqe)*
- *Menaxhimi mjedisor dhe social (20 faqe)*

Ne materialet e paraqitura jane percaktuar qarte te gjithe elementet ne raport me kerkesat e parashikuara ne dokumentat standarte sa i perket metodave te perdorura, personelit kryesor, disponeshmërise se pajisjeve kryesore, organizimit te stafit, sigurise, sigurimit te cilesise, planit te mobilizimit, etj

Plani i Kontraktorit per sigurimin e cilesise pershkruan metodat dhe procedurat te cilat kontraktori do te zbatoje per ekzekutimin e kontrates, duke perfshire idenifikimin e kerkesave e cilseve specifike te kontrates, inspektimet dhe testimet e punes duke siguruar pajtueshmerine me kerkesat e cilesise, procedurat dhe metodat qe do te perdoren per te kryer dhe monitoruar pajtushmerine e sherbimeve te mirembajtjes, etj. Stafi i paraqitur per tu angazhuar ne kontrate si

dhe menyra e organizimit i permbush kriteret per realizimin e kontrates. Ne grafikun e punimeve eshte evidentuar kryerja e punimeve sipas fazave.

Plani i Menaxhimit te Shëndetit dhe Sigurise siguron identifikimin sistematik te rreziqeve ekzistuese dhe te reja ne vendet e punimeve, siguron minimizimin e rreziqeve, siguron ofrimin dhe perdorimin e masave te pershtatshme mbrojtese, siguron vleresim dhe rishikim te rregullt per çdo rrezik te identifikuar si dhe monitoron ekspozimin e punonjësve ndaj ketyre rreziqeve, siguron raportimin dhe rregjistrimin e incidenteve të sigurisë ne vendin e punës ne mënyre të tille qe problemet e sigurise mund të adresohen shpejt dhe rregullisht etj.

Në planin e menaxhimit te trafikut jane realizuar objektivat e ketij plani ku jane percaktuar zhvillimi, implementimi dhe menaxhimi i masave dhe sistemeve te kontrollit te trafikut te sigurte dhe eficient, përmes dhe jashte vendeve te punimeve, mbrojtje e personelit ne çdo kohë, mbrojtje e aseteve duke permbushur kerkesat operacionale te rruges.

Kontraktori ka paraqitur masa per te siguruar qe e gjithë sinjalistika horizontale dhe vertikale pajtohen plotesisht me Standartet Rrugore Kombëtare Shqiptare gjate gjithë periudhës se zbatimit

Ne planin e menaxhimit mjedisor dhe social kontraktori ka percaktuar dhe pershkruar masat që do te ndermerren per minimizimin e ndikimit ne mjedis. Jane hartuar masat për menaxhimin mjedisor dhe masat per menaxhimin e integruar te mbetjeve. Jane hartuar procedurat për menaxhimin mjedisor, procedurat e menaxhimit te ceshtjeve sociale, menaxhimit te ankesave, permiresime te ekonomisë lokale te zones ku zhvillohet projekti etj.

Vlen të theksohet se është hartuar edhe vlerësimi i riskut të punimeve të mirembajtjes.

Për sa me siper, Komisioni i Shqyrtimit te Ankesave gjykon se materiali i paraqitur nga BOE “Ndërtuesi 2014” & “Varaku E” është në permbushje të dokumentave standarte te tenderit dhe pikët e dhëna nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave qëndrojnë.

Së dyti, ne lidhje me pretendimin tuaj per vleresimin me pike maksimale per propozimet per uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimit social, KSHA vlerëson se pikët maksimale do të jepen nëse permbushet maksimalisht minimizimi i te gjitha ndikimeve ne mjedis si psh: eliminimi korrekt i mbetjeve te rrezikshme (bojra apo kimikate te ndryshme, marreveshjeve me bashkite apo me te tretë per depozitimin korrekt te tyre, kafshe te aksidentuara etj.) Gjithashtu per vleresimin me piket maksimale nevojiten te gjitha makinerite te jene miqesore me mjedisin. Vleresimi me 4 pike per kete kriter eshte i mjaftueshëm duke marre parasysh planin e menaxhimit mjedisor dhe social te paraqitur nga ana juaj i cili e pmbush ne pergjithesi kete kriter.

Së treti, per sa I perket pretendimit tuaj per skualifikimin e bashkimit te operatoreve ekonomike “Ndertuesi 2014” SHPK & “Varaku E” SHPK si ofertë anomalisht e ulët, mbas shqyrtimit të dokumentacionit të nevojshëm, Komisioni I Shqyrtimit të Ankesës vëren se:

Me date 13.12.2024 Komisioni i Vleresimit te Ofertave ne sistemin elektronik te agjencise se prokurimit publik, ka derguar prane operatorit ekonomik “Ndertuesi 2014” SHPK & “Varaku E” SHPK, kerkesen per analizen e kostos se propozuar ne oferte si me poshte:

Komisioni i Vleresimit te Ofertave, ne lidhje me proceduren me objekt; “Loti 2: Mirembajtje me performance rruga “Koplik - Boge, Boge - Theth, Dedaj – Razem” (gjatesia totale 67,3 km), me vlere totale 329,552,917 (treqind e njezet e nente milion e peseqind e pesedhjetë e dy mijë e nentëqind e shtatëmbëdhjetë) Leke pa TVSH, Në Euro: 3,286,983.01 (tre milion e dyqind e tetëdhjetë gjashtë mijë e nentëqind e tetëdhjetë e tre pike zero nje) Euro pa TVSH”, Numri i references se procedures: REF-10945-06-24-2024, ka berë shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave te paraqitura. Bazuar në Vendimin 285, datë 19.05.2021, neni 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, pika 4 “Pas korrigjimit te gabimeve aritmetike, komisioni i vleresimit te ofertave verifikon nese ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës se percaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Perlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët behet në mënyrat e mëposhtme:

Në rastin kur janë te vlefshme dy ose më pak oferta, në perputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur; Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në perputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlejshme.

Komisioni i vlerësimit të ofertave konstaton se oferta e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik “Ndërtuesi 2014” & “Varaku E” SHPK është anomalisht e ulët. (pika a), më pak se 25% të fondit limit).

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave bazuar në nenin 93 “Oferta anomalisht e ulët” pika 1 “Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kerkon operatorit ekonomik te paraqesë me shkrim dhe brenda tri diteve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara ne oferte.

2. Shpjegimet e permendura në pikën 1 jepen veçanerisht për:

- a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;*
- b) zgjidhjet teknike te perzgiedhura dhe/ose ndonje kusht favorizues te jashtezakonshem qe ka ofertuesi per furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerien e punes,*
- c) originalitetin e punes, furnizimeve ose shërbimeve te propozuara nga ofemiedis i*
- ç) pajtueshmerine me delyrimet ge rrjedhin nga legjislacioni në fushen e mjedisit, ne fushën sociale dhe të punës;*
- d) mundisinë e ofertuesit per te marre ndihme shtetërore.*

Kërkon të analizoni strukturën e kostos sipas Udhëzimit Nr.2 date 08.05.2023 operatorit ekonomik te paraqese ne sistem dhe me shkrim dhe brenda tri diteve pune shpjegime per kostot e propozuara ne ofertë.

Më date 16.12.2024 operatorët ekonomik “Ndërtuesi 2014” & “Varaku E” shpk, kane paraqitur prane Komisionit te Vleresimit te Ofertave argumentimin ekonomik te ofertës dhe analizat e cmimeve per te gjithë elementet perberes te preventivit. Materiali i paraqitur permban:

- *Argumentimin ekonomik të ofertës*
- *Analizat e cmimeve*
- *Fatura tatimore*
- *Ofertë cmimesh.*

Referuar materialit të paraqitur, Komisioni i Shqyrtimit te Ankeses veren se nuk rezulton mosrespektim i normativave te formatit te analizave te manualit dhe analizat e paraqitura jane sipas zërave te punës te preventivit. Faturat tatimore te paraqitura dhe oferta e cmimeve justifikojnë analizat e paraqitura.

IV. Vendimi i komisionit të shqyrtimit te ankesës:

1. *Komisioni i shqyrtimit të ankesës vendosi te mos pranojë ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatoreve ekonomik “Rroku Guest & Deha 2010” SHPK per proceduren me objekt: Loti 2 Mirembajtje me performancë rruga Koplik - Bogë, Bogë - Theth, Dedaj - Razëm (gjatësia totale 67.3 km), me fond limit 329,552,917 (treqind e njezet e nënte milion e pesëqind e pesëdhjete e dy mije e nënteqind e shtatëmbëdhjetë) Lekë pa TVSh, me REF-10945-06-24-2024.*

II.17.10 Me shkresën nr. 3781/7 prot., datë 10.02.2025, dhe shkresën nr. 3781/8 prot, datë 19.02.2025 Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua autoritetit kontraktor për ti kërkuar informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i hartimit dhe miratimit të dokumentave standarde të tenderit, procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave për çdo fazë, procesverbalin e vlerësimit me pikë të ofertave për secilin komponentë, si dhe të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Rroku Gust” SHPK & “Deha 2010” SHPK, të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

II.17.11. Me shkresën përcjellëse me nr. 1267/1 prot., datë 24.02.2025, protokolluar me tonën me nr. 3781/9 prot., datë 26.02.2025, ku autoriteti kontraktor ka dërguar informacionin nëpërmjet shërbimit postar, me shkresën përcjellëse “Dërgim dokumentacioni”, në lidhje me shkresën nr. 3781/7 prot., datë 10.02.2025 të Komisionit Prokurimit Publik.

II.17.12 Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, janë paraqitur argumentet nga BOE i interesuar “Ndërtuesi 2014” & “Varaku E” SHPK, pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, nëpërmjet adresës elektronike të KPP-së si dhe shërbimit postar, në lidhje me procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK rishikimin e vlerësimit maksimal me pikë për bashkimin e operatorëve ekonomik “Ndërtuesi 2014” SHPK “Varaku E” SHPK përse i përket kriterit të vlerësimit të lidhur më cilësinë, si dhe për një vlerësim maksimal të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK përse i përket kriterit të vlerësimit lidhur me propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se;

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, kreu I “Udhëzime për operatorët ekonomikë”, pika 25 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese”, parashikon:

25 Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese

1 Autoriteti/Enti Kontraktor përcakton ofertën ekonomikisht më të favorshme në bazë të kriterëve të përcaktimit të ofertës fituese që janë përcaktuar në Njoftimin e Kontratës dhe në Dokumentet e Tenderit si më poshtë.

Opsioni 1) Oferta Ekonomikisht më e Favorshme, bazuar në kosto:

Lidhur me kriteret e vlerësimit, duhet përcaktuar qartë pesha specifike e secilit kriter, përkatësisht numri i pikëve për secilin kriter dhe mënyra se si do të llogariten pikët për ofertuesit e njëpasnjëshëm.

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave janë objektive dhe shprehen në shifra. Në çdo rast, kur ka më shumë se një kriter, pesha specifike e kriterit të çmimit nuk duhet të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që mund të marrë një Ofertë do të jenë 100.

Formula me të cilën llogariten pikët e ofertuesve, në çdo rast duhet të jetë:

$$Po = Pk1 + Pk2 + Pk3 + \dots$$

Ku:

Po - janë pikët totale të ofertës së vlerësuar

Pk1/Pk2/Pk3/... - janë pikët për secilin kriter të vlerësuar

Pikët për secilin kriter llogariten sipas formulës:

$$Pk1 = Vmink1 \times Pmaxk1 / Ok1$$

Pk1 _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

Vmink1 Vlera më e ulët e kriterit që vlerësohet

Pmaxk1 Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok1 Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

III.1.2. Në dokumentat e tenderit, Seksioni 4, “Procedura”, pika 4.4 “Kriteret e përzgjedhjes së fituesit”, janë përcaktuar kriteret e vlerësimit si më poshtë:

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto X

Sipas rëndësisë:

- **Çmimi** **pikët [0 - 60]**
- **Përvoja në shërbime të ngjashme** **pikët [0 - 20]**
- **Cilësia** **pikët [0 - 15]**
- **Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social** **pikët [0 - 5]**

Metodologjia e vlerësimit për Ofertën ekonomikisht më të favorshme bazuar në kosto

Kriteret e vlerësimit:

Të gjitha kriteret vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë më pak se 60 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100. Autoriteti kontraktor do të vlerësojë pikët për kriteret me vlerësim relativ (kriteri 1) e rrumbullakosur me dy shifra pas presjes dhjetore (0,00) ndërsa për kriteret me vlerësim absolut (kriteri 2.a/b, 3, 4.a/b) do të vlerësohen me numra të plotë (0).

Kriteri:

- 1. Çmimi** **[0 - 60 pikë]**

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = V_{\min k1} \times P_{\max k1} / O_{k1}$$

P_{k1} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\min k1}$ Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k1}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k1} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

2. Përvoja në shërbime të ngjashme

[0 - 20 pikë]

Operatori ekonomik duhet të përshkruaj përvojën e shërbimeve të ngjashme të realizuara në formën e CV, shoqëruar me vërtetim punimesh, të kryera në 10 vitet e fundit. Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

a. Përvojë e ngjashme, punime për ndërtim rrugësh / rikonstrukcion rruge [0 - 5 pikë]

b. Përvojë e ngjashme mirëmbajtje rrugësh [0 - 15 pikë]

3. Cilësia [0 - 15 pikë]

Treguesit dhe analiza cilësore në punë duke përcaktuar elementet e saj por pa u limituar në cilësinë e propozimit teknik për sa i përket metodave të përdorura, personelit kryesor, disponueshmërisë së pajisjeve kryesore, organizimi i stafit, siguria, sigurimit të cilësisë, planit të mobilizimit, garancia e punimeve të rehabilitimit dhe çdo aktiviteti tjetër.

4. Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social

[0- 5 pikë]

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një metodologji të qartë për minimizimin e ndikimit në mjedis të veprës si dhe propozimet e tij për menaxhimin e riskut mjedisor dhe social (sipas Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS)). Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

Nën-kriteri:

a. Propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike (miqësore me mjedisin) / të ricikluara / efçente / materiale që minimizojnë ndikimin mjedisor. Përdorimi i makinerive / pajisjeve ekologjike. Hartimi i një plan propozimi të menaxhimit dhe kontrollit

të minimizimit efekteve mjedisore.

[0 - 3 pikë]

b. Propozime konkrete për përmirësime të ekonomisë lokale të zones ku kryhet shërbimi si një iniciative sociale e ofertuesi nëpërmjet punësimeve.

[0 - 2 pikë]

**Shënim: Të gjithë dokumentacionet me propozime të përshkruara nga operatori ekonomik në plotësim të kriterëve të mësipërme të vlerësimit do të reflektojnë kushtet e kontratës (për të përfshirë propozimin konkret), duke mos implikuar asnjë kosto shtesë mbi vlerën e ofertuar për realizimin e punimeve të kontratës (sipas shtojcës nr. 1), për shkak të propozimeve të mësipërme*

III.1.3. Në përmbushje të kriterëve vlerësues për të cilat është përcaktuar dhe pesha specifike, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik SPE, ndër të tjera edhe dokumentacionin si më poshtë:

1. Cilësia;

- Cilësia
- Plan Manual Cilësisë për shërbimin e mirëmbajtjes;
- Plan operacional i mirëmbajtjes;
- Manual i menaxhimit të trafikut mirëmbajtja;
- Manuali jetës dhe shëndetit mirëmbajtja;
- Deklaratë për cilësinë;
- Godina e mirëmbajtjes;

2. Ndikimit në Mjedis dhe Social;

- Plan i menaxhimit mjedisor dhe social;
- Ndikimi social cert personale;
- Makinë elektrike për ndikimin në mjedis;

III.1.4. Në përmbushje të kriterëve vlerësues për të cilat është përcaktuar dhe pesha specifike, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Ndërtuesi 2014” SHPK & “Varaku E” SHPK ka paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik SPE, ndër të tjera edhe dokumentacionin si më poshtë:

1. Cilësia

- Plan i sigurimit të cilësisë;
- Plan operacional;

- Manuali mbrojtjes së jetës dhe shëndetit;
- Menaxhimi i trafikut;
- Vlerësimi i riskut

2. Ndikimit në Mjedis dhe Social;

III.1.5. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.1.6. Në nenin 43 “Procedurë e kufizuar” pika 3 e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

Në fazën e dytë të procedurës së kufizuar, ofertë mund të paraqesin vetëm kandidatët e përzgjedhur nga autoriteti ose enti kontraktor, në përputhje me nenin 58 të këtij ligji. Autoriteti ose enti kontraktor mund të kufizojë numrin e kandidatëve të përshtatshëm për t’u ftuar që të marrin pjesë në procedurë, në përputhje me parashikimet në këtë ligj. Në procedurat e kufizuara mbi kufirin e lartë monetar, afati minimal i përcaktuar nga autoriteti kontraktor për pranimin e ofertave është 30 ditë nga data në të cilën është shpallur ftesa për ofertë.

Në procedurat e kufizuara mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e prokurimit të kontratave sektoriale, afati kohor për marrjen e ofertave mund të përcaktohet me anë të një marrëveshjeje të përbashkët ndërmjet entit kontraktor dhe kandidatëve të përzgjedhur, me kusht që të gjithë kandidatëve të përzgjedhur t’u jepet kohë e barabartë për të përgatitur dhe dorëzuar ofertat e tyre. Në mungesë të marrëveshjes për afatin kohor për pranimin e ofertave, afati kohor është të paktën 10 ditë nga data në të cilën është shpallur ftesa për ofertë.

III.1.7. Në nenin 45 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, pika 1, 2, 7 dhe 8 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht:

Autoriteti/enti kontraktor përcakton dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme.

Oferta, ekonomikisht më e favorshme, identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenet 87 dhe 88 të LPP-së dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kriterëve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale.

Autoriteti/enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i jep çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme, me përjashtim të rasteve kur kjo identifikohet vetëm mbi bazën e çmimit.

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.

Për kriteret vlerësuese duhet përcaktuar pesha specifike e secilit kriter dhe konkretisht pikët që do të ketë çdo kriter dhe mënyra e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e njëpasnjëshëm. Formula që zbatohet në këtë rast parashikohet në dokumentet standarde të tenderit.

III.1.8. Neni 47 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

1. Autoriteti/enti kontraktor përcakton dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme.

2. Oferta, ekonomikisht më e favorshme, identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenet 87 dhe 88 të LPP-së dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kriterëve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale.

2.1. Për furnizimin me karburant, gazoil, benzol dhe karburant për ngrohje, në rastet kur oferta ekonomikisht më e favorshme bazohet në çmimin më të ulët, ky i fundit përllogaritet bazuar në:

a) çmimin e bursës, lëvruar sipas kushtit CIF-Shqipëri, i cili dërgohet për publikim çdo javë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në Buletin e Njoftimeve Publike;

b) elementet fiskale;

c) normën e fitimit të shprehur në vlerë absolute, e cila duhet të jetë e pandryshuar gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës .

3. Për punët/mallrat/shërbimet që kanë specifikime të thjeshta, standarde teknike të mirënjohura dhe janë lehtësisht të gjendura në treg, oferta ekonomikisht më e favorshme, bazohet në çmimin si i vetmi element i ndryshueshëm ndërmjet ofertave.

4. Në kontratat që përveç çmimit për punën/mallin/shërbimin, objekt i kontratës, përmban dhe elemente të tjera, që kanë vlerë ekonomike dhe i ngarkojnë autoritetit/entit kontraktor shpenzime gjatë fazës së zbatimit të saj ose dhe më tej, kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme bazohet në:

a) cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë, projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij; dhe/ose

b) organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës; dhe/ose

c) shërbimin koston pas shitjes dhe asistencën teknike, kushtet e dorëzimit, si p.sh. datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.

5. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese konsiderohen se janë të lidhura me objektin e kontratës, kur ato lidhen me punët, furnizimet ose shërbimet që do të ofrohen në zbatim të asaj kontrate në çdo drejtim dhe në çdo fazë të ciklit të tyre jetësor, duke përfshirë faktorët që bëjnë pjesë në:

a) procesin specifik të prodhimit, ofrimit ose tregtimit të atyre punëve, furnizimeve ose shërbimeve; ose

b) një proces specifik, për një fazë tjetër të ciklit të tyre jetësor, edhe kur këta faktorë nuk janë pjesë e substancës së tyre thelbësore.

6. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit, të verifikohen, për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Në rast dyshimi, autoriteti/enti kontraktor verifikon saktësinë e informacionit dhe provat e paraqitura nga ofertuesit.

7. Autoriteti/enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i jep çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme, me përjashtim të rasteve kur kjo identifikohet vetëm mbi bazën e çmimit.

8. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehesh në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.

III.1.9. Në nenin 48 “Procedura e kufizuar”, të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht:

Procedura e kufizuar, sipas nenit 43, të LPP-së, është procedurë prokurimi me dy faza, që mund të përdoret nga çdo autoritet/ent kontraktor që prokuron punë/shërbime/mallra, në të cilën mund të marrë pjesë çdo operator ekonomik i interesuar.

Pas mbylljes së fazës së parë të kualifikimit dhe në përfundim të afateve të ankimit, sipas parashikimit në nenin 110, të LPP-së, autoriteti/enti kontraktor fton kandidatët e përzgjedhur të dorëzojnë ofertat.

Ofertat duhet të hartohen në bazë të specifikimeve teknike të përcaktuara në ftesën për ofertë, sipas afateve të përcaktuara në nenin 43, të LPP-së.

Në përfundim të procesit të vlerësimit të dokumentacionit të ofertuesve, në bazë të kriterëve të përcaktuara në nenet 76 e 77, të LPP-së dhe këtyre rregullave, autoriteti/enti kontraktor përzgjedh ofertën fituese, pas krahasimit të ofertave, bazuar në kriteret e përcaktuara në nenin 87 të LPP-së.

III.1.10. Në nenin 87 “Kriteret për shpalljen e ofertës fituese” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë dhënien e kontratave publike bazuar në ofertën ekonomikisht më të favorshme.

2. Oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenin 88 të këtij ligji, dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kriterëve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale.

Kritere të tilla mund të përfshijnë:

a) cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë, projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij;

b) organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës; ose

c) shërbimin pas shitjes dhe asistencën teknike, kushtet e dorëzimit, si, për shembull, datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.

Elementi i kostos, gjithashtu, mund të marrë formën e një çmimi ose kostoje fikse, mbi bazën e të cilit operatorët ekonomikë do të konkurrojnë vetëm për kriteret e cilësisë.

3. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese konsiderohen se janë të lidhura me objektin e kontratës, kur ato lidhen me punët, furnizimet ose shërbimet që do të ofrohen në zbatim të asaj kontrate në çdo drejtim dhe në çdo fazë të ciklit të tyre jetësor, duke përfshirë faktorët që bëjnë pjesë në:

a) procesin specifik të prodhimit, ofrimit ose tregtimit të atyre punëve, furnizimeve ose shërbimeve; ose

b) një proces specifik, për një fazë tjetër të ciklit të tyre jetësor, edhe kur këta faktorë nuk janë pjesë e substancës së tyre thelbësore.

4. Kriteret për shpalljen e kontratës fituese nuk i japin autoritetit ose entit kontraktor një liri të pakufizuar zgjedhjeje. Ato garantojnë mundësinë e konkurrencës efektive dhe shoqërohen nga specifikime, të cilat lejojnë që informacionet e dhëna nga ofertuesit të verifikohen për të vlerësuar nëse ofertat përmbushin kriteret për shpalljen e kontratës fituese. Në rast dyshimi, autoritetet ose entet kontraktore verifikojnë saktësinë e informacionit dhe provat e paraqitura nga ofertuesit.

5. Autoriteti ose enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i jep çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme, me përjashtim të rasteve kur kjo identifikohet vetëm mbi bazën e çmimit.

Nëse përcaktimi i shkallës së rëndësisë nuk është i mundur për arsye objektive, autoriteti ose enti kontraktor i paraqet kriteret sipas rëndësisë në rend zbritës.

III.1.11. Në nenin 88 “Llogaritja e kostos gjatë ciklit jetësor” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se:

1. Llogaritja e kostos gjatë ciklit jetësor mbulon, nëse është e mundur, të gjitha ose një pjesë të kostove të mëposhtme përgjatë ciklit jetësor të një produkti, shërbimi ose të punëve:

a) kostot që mbulohen nga autoriteti ose enti kontraktor ose nga përdorues të tjerë, si:

i. kostot që lidhen me blerjen;

ii. kostot e përdorimit, siç janë konsumi i energjisë dhe burime të tjera;

iii. kostot e mirëmbajtjes;

iv. kostot në fund të kohës së përdorimit, si kostot për grumbullim dhe riciklim.

b) kostot mbi efektet mjedisore dytësore që lidhen me produktin, shërbimin ose punët gjatë ciklit të tyre jetësor, me kusht që vlera e tyre monetare të mund të përcaktohet dhe të verifikohet. Këto kosto mund të përfshijnë koston e emetimit të gazeve me efekt serë dhe emetimeve të ndotësve të tjerë dhe kosto të tjera për zbutjen e ndryshimit klimatik.

2. Kur autoritetet ose entet kontraktore i vlerësojnë kostot duke përdorur metodën për llogaritjen e kostove të ciklit jetësor, ato përcaktojnë në dokumentet e tenderit të dhënat që duhet të ofrohen nga ofertuesit dhe metodën që do të përdorë autoriteti ose enti kontraktor për të përcaktuar kostot e ciklit jetësor, mbi bazën e këtyre të dhënave.

Metoda që përdoret për të llogaritur kostot mbi efektet mjedisore anësore duhet të përmbushë kushtet e mëposhtme:

- a) bazohet mbi kritere objektivisht të verifikueshme dhe jodiskriminuese.*
- b) nëse nuk është krijuar për t'u zbatuar në mënyrë të përsëritur ose të vazhdueshme, metoda nuk favorizon ose diskriminon në mënyrë të padrejtë disa operatorë ekonomikë;*
- c) është e aksesueshme për të gjitha palët e interesuara;*
- ç) të dhënat e kërkuara mund të sigurohen pa vështirësi nga operatorët ekonomikë.*

III.1.12. Referuar bazës ligjore të sipërcituar dhe kritereve të vlerësimit të përcaktuara në dokumentat e tenderit parashikohet se faza e dytë e procedurës së prokurimit objekt ankimi për përcaktimin e ofertës ekonomike më të favorshme i nënshtrohet vlerësimit të 4 (katër) kritereve të vlerësimit, të cilat janë çmimi i ofertës ekonomike, përvoja në shërbime të ngjashme, cilësia e punimeve të propozuara dhe propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social. Lidhur me kriterin e vlerësimit cilësia e punimeve të propozuar, autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për këtë kriter vlerësimi ka përcaktuar peshën e këtij kriteri me intervalin 0-15 pikë, ku për vlerësimin me pikë bazuar në këtë kriter operatorët ekonomikë ofertues duhet të propozojnë treguesit dhe analiza cilësore në punë, duke përcaktuar elementet e saj si për shembull, por pa u limituar në cilësinë e propozimit teknik për sa i përket metodave të përdorura, personelit kryesor, disponueshmërisë së pajisjeve kryesore, organizimi i stafit, siguria, sigurimit të cilësisë, planit të mobilizimit, garancia e punimeve të rehabilitimit dhe çdo aktiviteti tjetër. Ndërsa lidhur me kriterin e vlerësimit propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për këtë kriter vlerësimi ka përcaktuar peshën e këtij kriteri me intervalin 0-5 pikë, ku për vlerësimin me pikë bazuar në këtë kriter operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin një metodologji të qartë për minimizimin e ndikimit në mjedis të veprës si dhe propozimet e tij për menaxhimin e riskut mjedisor dhe social (sipas Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS), por vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet i ndarë në 2 (dy) nën-kritere, ku nën-kriteri i parë është propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike (miqësore me mjedisin) / të ricikluara / efikente / materiale që minimizojnë ndikimin mjedisor. Përdorimi i makinerive / pajisjeve ekologjike. Hartimi i një plan propozimi të menaxhimit dhe kontrollit të minimizimit efekteve mjedisore, ku për këtë nën-kriter autoriteti kontraktor ka përcaktuar peshën e këtij nën-kriteri me intervalin 0-3 pikë, ndërsa nën-kriteri i dytë është propozimi konkret për përmirësime të ekonomisë lokale të zones ku kryhet shërbimi si një iniciative sociale e ofertuesi nëpërmjet punësimeve, ku për këtë nën-kriter autoriteti kontraktor ka përcaktuar peshën e këtij nën-kriteri me intervalin 0-2 pikë. Oferta, ekonomikisht më e favorshme, identifikohet në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor, në përputhje me nenet 87 dhe 88 të LPP-së dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kritereve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale. Autoriteti/enti kontraktor specifikon në dokumentet e tenderit shkallën e rëndësisë relative që i jep çdo kriteri të zgjedhur për të përcaktuar ofertën ekonomikisht më të favorshme. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur

kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë.

Çmimi □	pikët 50
Grafiku i punimeve dhe metodologjia □□	pikët 15
Stafi / Organizimi i Kompanisë □ □	pikët 15
Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social □□	pikët 10
Periudha e garancisë dhe mirëmbajtjes rutinë të objektit □□	pikët 10

Për kriteret vlerësuese duhet përcaktuar pesha specifike e secilit kriter dhe konkretisht pikët që do të ketë çdo kriter. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë, se fakti se autoriteti kontraktor ka përcaktuar si kriter të përcaktimit të ofertës fituese, atë të ofertës ekonomike më të favorshme, vlerësimi i ofertave të operatorëve ekonomikë duhet ti nënshtrohen një analize të thellë dhe të detajuar dyplanëshe, së pari mbi vetë dokumentacionin e dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik ankimues mbi kriterin e kërkuar dhe së dyti në rrafsh krahasimor edhe me dokumentacionin e dorëzuar nga operatorët e tjerë ekonomikë, duke bërë kështu një analizë të thellë midis ofertave dhe dokumentacionit të paraqitur, në rastet kur operatorët ekonomikë kanë ngritur pretendime.

III.1.13. Komisioni i Prokurimit Publik nënvizon se është në të drejtën e autoritetit kontraktor në cilësinë e autoritetit përgjegjës për prokurimin e fondeve publike në kuptim të nenit 21, të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “*Për Prokurimin Publik*” që të përzgjedhë në përputhje me nenin 87 të ligjit për prokurimin publik mes kriterit të përcaktimit të ofertës fituese: çmimi më i ulët ose oferta ekonomike më e favorshme. Diskrecioni i lënë nga ligjvënësi (*mes përzgjedhjes së kriterit të përcaktimit të ofertës fituese*) i nënshtrohet parimit të ligjshmërisë, në zbatim edhe të nenit 11 të ligjit nr.44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”. Konkretisht, diskrecioni për të përcaktuar kriteret e përzgjedhjes në rast të aplikimit të ofertës ekonomike më të favorshme si kriter i përcaktimit të ofertës fituese, është kufizuar nga ligjvënësi në mënyrë eksplicite, në nenin 87 të ligjit për prokurimin publik, ku inter allia shprehet se oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kriteret e ndryshme të lidhura me objektin e kontratës që prokurohet, si: në bazë të çmimit ose kostos, duke përdorur metodën e efektivitetit të kostos, siç janë kostot gjatë ciklit jetësor dhe mund të bazohet në raportin më të mirë çmim-cilësi, që vlerësohet mbi bazën e kriterëve që lidhen me objektin e kontratës në fjalë, duke përfshirë cilësinë, aspektet mjedisore dhe/ose sociale. Kriteret e tilla mund të përfshijnë cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë, projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij.

Gjithashtu, edhe në nenin 45 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, të ndryshuar, është përcaktuar se: “*Në kontratat, që përveç çmimit për punën/mallin/shërbimin, objekt i kontratës, përmban dhe elemente të tjera, që*

kanë vlerë ekonomike dhe i ngarkojnë autoritetit/entit kontraktor shpenzime gjatë fazës së zbatimit të saj ose dhe më tej, kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme bazohet, në:

- a) cilësinë, duke përfshirë meritat teknike, karakteristikat estetike dhe funksionale, aksesueshmërinë, projektimin për të gjithë përdoruesit, karakteristikat mjedisore dhe novatore, si dhe tregtimin dhe kushtet e tij; dhe/ose*
- b) organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit që është emëruar për të zbatuar kontratën, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës; dhe/ose*
- c) shërbimin, koston pas shitjes dhe asistencën teknike, kushtet e dorëzimit, si p.sh. datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.”.*

Sa më sipër, në respekt të nenit 87 të ligjit për prokurimin publik si edhe nenit 45 të rregullave të prokurimit publik, është në të drejtë të autoritetit kontraktor të vendosë kritere vlerësimi të përcaktimit të ofertës fituese, si edhe t'u japë peshë specifike me një sistem të posacëm pikëzimi. Gjithashtu, Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë, faktin se autoriteti kontraktor ka përcaktuar si kriter të përcaktimit të ofertës fituese atë të ofertës ekonomike më të favorshme ku vlerësimi i ofertave të operatorëve ekonomikë duhet ti nënshtrohen një analize të thellë dhe të detajuar dy planëshe, së pari mbi vetë dokumentacionin e dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik ankimes mbi kriteret e vlerësimit të kërkuara (cilësia dhe propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social) dhe së dyti në rrafshin krahasimor edhe me dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik vlerësuar me pikët maksimale, duke bërë kështu një analizë të thellë midis ofertave dhe dokumentacionit të paraqitur, në rastet kur operatorët ekonomikë kanë ngritur pretendime. Në këtë mënyrë, do të garantohen edhe dy prej parimeve kyç të zhvillimit të procedurave të prokurimit ajo e transparencës dhe barazisë. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se (*ratio legis*) e përdorimit të kriterit të përcaktimit të ofertës fituese si oferta ekonomike më e favorshme lidhet pikërisht me kompleksitetin e kontratës, ku krahas çmimit të kryerjes së punimeve, një rol të rëndësishëm luajnë gjithashtu cilësia e punimeve dhe propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social, për të cilat autoriteti kontraktor ka përzgjedhur ta peshojë me 15 pikë cilësinë e punimeve, ndërsa me 5 pikë propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, ndonëse vlerësimi me pikë bazohet në gjykimin personal dhe individual të secilit prej anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave, brenda diapazonit me pikë, të përcaktuar në dokumentat e tenderit, por nga ana tjetër ky vlerësim dhe gjykim, nuk duhet të jetë subjektiv, por i bazuar dhe arsyetuar mbi dokumentacionin e paraqitur nga secili operator ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, Komisioni, gjykon se, procesi i pikëzimit, duhet të bëhet në përputhje dhe në proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga secili ofertues, i cili, nga ana tjetër, duhet të jetë sa më afër kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Fryma e ligjit të prokurimit publik, është e tillë që, çdo operator duhet të përgatisë ofertën e tij në përputhje me kriteret dhe kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit.

III.1.7. Në lidhje me kriterin e vlerësimit përsa i përket cilësisë, në dokumentet e procedurës së prokurimit, autoriteti kontraktor ka përcaktuar se vlerësimi do të kryhet mbi treguesit dhe analiza cilësore në punë, duke përcaktuar elementet e saj si për shembull, por pa u limituar në cilësinë e propozimit teknik për sa i përket metodave të përdorura, personelit kryesor, disponueshmërisë së pajisjeve kryesore, organizimi i stafit, siguria, sigurimit të cilësisë, planit të mobilizimit, garancisë së punimeve të rehabilitimit dhe çdo aktiviteti tjetër, ndërsa përsa i përket kriterit të vlerësimit lidhur me propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për këtë kriter vlerësimi ka përcaktuar peshën e këtij kriteri me intervalin 0-5 pikë, ku për vlerësimin me pikë bazuar në këtë kriter operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin një metodologji të qartë për minimizimin e ndikimit në mjedis të veprës, si dhe propozimet e tij për menaxhimin e riskut mjedisor dhe social (sipas Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS), por vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet i ndarë në 2 (dy) nën-kritere, ku nën-kriteri i parë është propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike, përdorimi i makinerive/ pajisjeve ekologjike dhe hartimi i një plan propozimi të menaxhimit dhe kontrollit të minimizimit efekteve mjedisore, ku për këtë nën-kriter autoriteti kontraktor ka përcaktuar peshën e këtij nën-kriteri me intervalin 0-3 pikë, ndërsa nën-kriteri i dytë është propozimi konkret për përmirësime të ekonomisë lokale të zones, ku për këtë nën-kriter autoriteti kontraktor ka përcaktuar peshën e këtij nën-kriteri me intervalin 0-2 pikë.

Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në rastin konkret në përcaktimin e pikëve për kriteret e sipërpërmendura fillimisht ofertuesit duhet të dorëzojnë dokumentat konkretë që pasqyrojnë elementët e sipërpërmendur për secilin kriter vlerësimi dhe më pas në rrafshin krahasimor, duke përcaktuar se kush ka dhënë propozimet më të mira do të përcaktojë pikët për secilin ofertues përsa i përket këtyre kritereve. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se synimi i autoritetit kontraktor nuk lidhet me riprodhimin e termave të referencës së kryerje së shërbimit, por në drejtim të përmirësimit të tij, riorganizimit, sigurimit të cilësisë ose elementë të tjerë favorizues, që në thelb do të përbënin ofertën ekonomikë më të favorshme dhe do të garantonin cilësinë e kryerjes së shërbimit. Në lidhje me cilësinë për të cilën nga ana e autoritetit kontraktor është parashikuar një interval pikësh nga **[0 - 15 pikë]**, treguesit dhe analiza cilësore (në shërbimin e mirëmbajtje me performancë të rrugës për Lotin 2 objekt prokurimi), duke përcaktuar elementet e saj por pa u limituar në cilësinë e propozimit teknik për sa i përket metodave të përdorura, personelit kryesor, disponueshmërisë së pajisjeve kryesore, organizimi i stafit, siguria, sigurimit të cilësisë, planit të mobilizimit, garancia e punimeve të rehabilitimit dhe çdo aktiviteti tjetër. Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë, faktin se autoriteti kontraktor ka përcaktuar si kriter të përcaktimit të ofertës fituese atë të ofertës ekonomike më të favorshme vlerësimi i ofertave të operatorëve ekonomikë duhet ti nënshtrohen një analize të thellë dhe të detajuar dy planëshe, së pari mbi vetë dokumentacionin e dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik ankimes mbi kriterin e kërkuar (propozimit teknik ose cilësia) dhe së dyti në rrafsh krahasimor edhe me dokumentacionin e dorëzuar nga operatori ekonomik ekonomik tjetër pjesëmarrës, duke bërë kështu një analizë të thellë midis ofertave dhe dokumentacionit të paraqitur. Në këtë mënyrë, do të garantohen edhe dy prej parimeve kyç të zhvillimit të procedurave të prokurimit ajo e transparencës dhe barazisë.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se (ratio legis) e përdorimit të kriterit të përcaktimit të ofertës fituese si oferta ekonomike më e favorshme, lidhet pikërisht me kompleksitetin e kontratës, ku krahas çmimit të kryerjes së shërbimit, një rol të rëndësishëm luajnë gjithashtu edhe cilësia e shërbimit, zgjidhjet teknike për të cilat autoriteti kontraktor ka përzgjedhur të peshojë me 15 pikë, cilësinë dhe metodologjinë e kryerjes së shërbimit. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, ndonëse vlerësimi me pikë megjithëse bazohet në gjykimin personal dhe individual të secilit prej anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, brenda diapazonit me pikë, të përcaktuar në dokumentat e tenderit. Por nga ana tjetër, ky vlerësim dhe gjykim, nuk duhet të jetë subjektiv, por i bazuar dhe arsyetuar mbi dokumentacionin e paraqitur nga secili operator ekonomik/ofertues pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, Komisioni, gjykon se, procesi i pikëzimit, duhet të bëhet në përputhje dhe në proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga secili ofertues, i cili, nga ana tjetër, duhet të jetë sa më afër kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Fryma e ligjit të prokurimit publik, është e tillë që, çdo operator duhet të përgatisë ofertën e tij në përputhje me kriteret dhe kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit. Në lidhje me cilësinë, si në dokumentet e procedurës së prokurimit, ashtu edhe në ftesën për ofertë autoriteti kontraktor ka përcaktuar se vlerësimi do të kryhet mbi treguesit dhe analiza cilësore në kryerjen e shërbimit duke përcaktuar elementet e saj referuar termave të referencës së cilësuar nga ana e autoritetit kontraktor por pa u limituar në cilësinë e propozimit teknik për sa i përket metodave të përdorura, personelit kryesor, disponueshmërisë së pajisjeve kryesore, organizimi i sitit, siguria, sigurimit të cilësisë, planit të mobilizimit, grafikut të punimeve dhe çdo aktiviteti tjetër siç mund të përcaktohet nga punëdhënësi. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, në rastin konkret, në vlerësimin e metodologjisë së dorëzuar do të merren në konsideratë elementët konkretë për të gjithë treguesit cilësore të shërbimit (personeli kryesor, pajisjet kryesore, organizimi i stafit, siguria, sigurimi i cilësisë, plani i mobilizimit, garancia e punimeve dhe çdo aktivitet tjetër), zbërthyer kjo në të gjitha elementet e saj. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se synimi i autoritetit kontraktor nuk lidhet me ri prodhimin e termave të referencës së kryerje së shërbimit, por në drejtim të përmirësimit të tij, organizimit, sigurimit të cilësisë ose elementë të tjerë favorizues, që në thelb do të përbënin ofertën ekonomike më të favorshme dhe do të garantonin cilësinë e kryerjes së shërbimit. Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga secili ofertues BOE “Rroku Guest” & “Deha 2010” SHPK dhe BOE “Ndërtues 2014” SHPK & “Varaku E” SHPK, Komisioni konstaton se, operatorët ekonomikë pjesëmarrës kanë paraqitur materiale për cilësinë e Propozimit Teknik, ku BOE “Ndërtues 2014” Shpk & “Varaku E” Shpk ka paraqitur dokumentacionin, si vijon: Plani i Sigurimit të Cilësisë; Manuali i mbrotjes së jetës dhe shëndetit; Manuali i menaxhimit të trafikur dhe emergjencës; Menaxhimi Mjedisor dhe Social; Plani operacional i mirëmbajtjes dhe disponueshmërisë dhe Tabela vlerësimit të rriskut të punimeve të mirëmbajtjes. - Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga ana e BOE për konponentët e kriterit “cilësia” për “sigurimin e cilësisë”, ka dorëzuar një *“Plan mbi sigurimin e cilësisë në mirëmbajtje”* prej 10 faqesh, ku evidentohet se, është bërë një përshkrim narrativ mbi qëllimin e tij, struktura organizimit në staf në nivel qendror dhe nivel kantieri, hapat procedural mbi auditimin e cilësisë gjatë fazës së mirëmbajtjes, korrespondenca midis palëve, një përshkrim

procedural mbi hapat që do të ndiqen për mirëmbajtjen, kontrollet dhe testimet. Të gjitha pajisjet e nevojshme dhe pajisjet dhe aparatet e testimit, që i përkasin kontraktuesit ose që sigurohen nga laboratorët e jashtëm, duhet të mbahen të efektshme dhe me kalibrim të vlefshëm, sipas kodeve dhe standardeve ndërkombëtare të zbatueshme dhe të kontrolluara. Në organigramën e BOE kemi edhe sektorin përkatës të Menaxhimit të Cilësisë lëshon Librin zyrtar të Kalibrimit që përmban listën e pajisjeve të tilla dhe certifikatave përkatëse të kalibrimit. - Në lidhje me metodat e përdorura është përcaktuar edhe metodologjia e punime të mirëmbajtjes ku përfshihen masat konkrete mbi mirëmbajtjen rrugore dimërore, mbi mirëmbajtjen rrugore rutinë, përshkrim të punimeve të rehabilitimit + periodike të detajuara sipas detyrave respektive, ku përfshin: Pastrimi i kanaleve dhe kunetave, Mbushja dhe nivelimi i bankinave, Pastrimi i vegjetacionit, Pastrimi i karrexhatës nga aluvionet dhe materiale të tjera, Riparimi i gropave të asfaltit, Mbushje dhe profilim i nënshtresave në rrugët me asfalt, Riparimi dhe rifreskimi i sinjalistikës horizontale, Riparimi dhe rifreskimi i sinjalistikës vertikale, pajisjeve të sigurisë rrugore (mbrojtëset metalike), masat konkrete për Mirëmbajtje rutinë e veprave të artit, masat konkrete për Punimet e mirëmbajtjes Dimërore. - Në lidhje me personelin kryesor, organizimin e stafit dhe sigurinë, BOE ka paraqitur një material prej 37 faqesh “Manuali i mbrojtjes së jetës dhe shëndetit (faza e mirëmbajtjes)”, shoqëruar edhe në trajtë tabelare (26 faqe) dhe një material prej 35 faqesh “Manuali i menaxhimit të trafikut dhe emergjencës”, Politikat e Kontraktorit mbi Mbrojtjen e Shëndetit dhe Jetës janë zhvilluar nga departamenti i Sigurisë në perputhje me Politikat e BOE “Ndërtuesi 2014” SHPK & “Varaku E” SHPK, legjisllacioneve aktuale mbi shëndetin, sigurinë dhe ambjentin të Republikës së Shqipërisë dhe Standartet Ndërkombëtare. Në vijim është paraqitur organigram e projektit me pozicionet e personelit dhe përgjegjësitë/detyrat për këtë projekt. Qëllimi i secilit prej manualeve, ku evidentohet një informacion i përgjithshëm mbi procesin e mirëmbajtjes duke përcaktuar edhe detyrat kryesore të inspektimit, politikat e mbrojtjes së shëndetit dhe jetës, organigrama e personelit kryesor në trajtë skematike duke cilësuar detyrat respektive sipas pozicionit të punës, sistemi i trajnimit të personelit duke përcaktuar edhe temat e trajnimit, procedurat e sigurisë dhe shëndetit në punë, udhëzime për menaxhimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve, procedurat e emergjencave si dhe pasqyrimi në trajtë tabelare mbi procedurën e vlerësimit të rrezikut. Plani i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë, i cili përmban instruktimin teknik të stafit të shoqërisë në varesi të llojit të punës dhe sidomos instruktimin për punimet në rrugë, kontrolli dhe menaxhimi i trafikut rrugor si dhe montimi i sinjalistikës rrugore (vertikale dhe horizontale) ku përfshin masat për kontrollin e duhur të trafikut siç nevojitet apo kërkohet nga mbikqyrësi, ka parashikuar të vendosë persona me flamur ose semafor levizes, detyra të cilëve do të jetë të drejtojnë lëvizjen e trafikut përmes ose anash punimeve. Me qëllim minimizimin e ndërprerjes së trafikut, nga stafi shoqërisë parashikohet të mbyllet me gardh përkohësisht pjesa e sheshit të ndërtimit, siç nevojitet për të siguruar një barrierë vizive midis zonës së punimeve dhe trafikut të afërt. Gjithashtu ky BOE ka parashikuar edhe planin e emergjencave ku reagimi ndaj emergjencave përfshin aktivitete për veprimet e menjehershme dhe afatshkurtra për të ruajtur jetën, pronën, mjedisin dhe strukturën shoqërore, ekonomike dhe politike të komunitetit.

BOE “Ndërtuesi 2014” SHPK & “Varaku E” SHPK ka ngritur një strukturë përgjegjëse për informacionet e përgjithshme dhe trajnimin e personelit të saj dhe ato specifike të lidhura me ligjin dhe për organizimin e punimeve të mirëmbajtjes në rrugë dhe aktivitetet, duke përfshirë certifikimin e nevojshëm kur nevojitet. Gjithashtu, BOE në lidhje me *Menaxhimin e Trafikut* në fazën e mirëmbajtjes është e një rëndësie të veçantë, për shkak se të gjitha pothuajse aktivitetet/punimet e mirëmbajtjes do të zhvillohen në afërsi ose direkt në rrugën Koplik - Bogë + Bogë – Theth + Dedaj – Razëm ku shpejtësia e lëvizjes së automjeteve dhe fluksi do të jetë mesatare për shkak dhe të atraksionit turistik që paraqet kjo zonë. Prandaj dhe të gjithë peronat e përfshirë në këtë proces do të jene të mirë informuar dhe të kualifikuar, trajnuar. Për këtë arsye janë renditur edhe disa masa të përgjithshme për operimin dhe sigurinë gjatë fazës së mirëmbajtjes dhe ekzekutimit të punimeve. Për më tepër, në lidhje me situatat emergjente, BOE ka bërë një përshkrim të detajuar në lidhje me hapat që do të ndiqen. Ku konkretisht, i gjithë stafi do të miratojë dhe ngrejë një strukturë të veçantë në rast emergjence, ku janë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e strukturës tipike që do të merret në rastet emergjente. Për këtë qëllim, BOE ka hartuar një manual për menaxhimin e trafikut dhe emergjencave, ku në fokus është minimizimi i bllokimit të trafikut ne akset rrugore Koplik - Bogë + Bogë – Theth + Dedaj – Razëm, për të siguruar që përdoruesit e rrugës të mos shqetësohen dhe se ky aks rrugor do të mbahet në një nivel të kënaqshëm performance ku do të garantohet një lëvizje e sigurt, e shpejtë dhe e lehtë për automjetet e emergjencave. Gjithashtu ka dhënë një përshkrim të gjendjes aktuale të rrugëve që do të kenë mirëmbajtje rutinë dhe operacione të riparimit të segmenteve rrugorë, ku mirëmbajtja dimerore, largimi i dëborës mund të realizohet vetëm me borë pastruese me shnek. Pasi terreni nëpër të cilën kalon kjo rrugë ka kthesa te forta dhe te ngushta dhe nuk lejojnë lëvizjen me shpejtesinë e duhur për borëpastruese me thikë, pothuajse e gjithë rruga është me guardrails dhe nuk ka vend ku të depozitohet bora ndaj duhet hedhur larg trupit të rruges. Në zonën alpine ku kalon rruga rreshjet e dendura i kalojnë 50 — 60 cm njeherësh duke bërë të pamundur përdorimin e borëpastrueseve me thike, ndaj është e domosdoshme borëpastruese me shnek për të cilat kompania jonë disponon 5 borëpastruese të tilla në pronësi të cilat do të jenë në dispozicion për të bërë ndërhyrje të menjëhershme në çdo situatë. Për të gjitha planet e menaxhimit të trafikut stafi i angazhuar në kontratë ku do të kryejë shërbimin do t'i referohet dhe konsultohet me manualin e sinjalistikës dhe skemat përkatëse dhe sipas kodit rrugor të R.Sh. Gjithashtu, një person i kualifikuar për çështjet e Shëndetit & Sigurisë është parashikuar që do të emërohet për fazën e mirëmbajtjes për të garantuar që punimet do të kryhen në mënyrë korrekte për të shmangur çdo risk të mundshëm, sado i vogël që të jetë. BOE “Ndërtuesi 2014” SHPK & “Varaku E” SHPK ka parashikuar të mundesojë forcën punëtore të gjitha informacionet dhe trajnimet e nevojshme për të kryer punën në mënyrë të sigurtë. Gjithashtu ky BOE ka parashikuar dhe një strukturë të posaçme për ofrimin e shërbimeve të asistencës rrugore shërbimet e emergjencës. Gjithashtu parashikon ngritjen e një sistemi i cili do të mbledh dhe analizojë kushtet e motit në mënyrë që të ketë një reagim sa më të shpejtë në rast stuhish dhe emergjencash. - Në lidhje me metodat e përdorura, planin e mobilizimit, personelin kryesor dhe pajisjet kryesore, BOE ka paraqitur një material prej 57 faqesh, *Plani Operacional i Mirëmbajtjes dhe disponueshmërisë*, ku evidentohet në trajtë tabelare dhe narrative

stafi që është i nevojshëm të angazhohet në periudhën e mirëmbajtjes së objektit, i cili është gjithëpërfshirës por jo domosdoshmërisht i nevojshëm gjatë gjithë kohës në kantier apo për proceset e punë specifike (i cili përvecëse ka deklaruar një staf që tejkalon kërkesat e autoritetit kontraktor ka deklaruar disponimin edhe të një mjeku të përgjithshëm i cili do të jetë i atashuar në kantier me qëllim ndërhyrjen kur është e nevojshme në rastet e emergjencave), organigrama dhe një përshkrim të personelit kryesor dhe atij të kualifikuar (si inxhinier, manovrator, shofera, mekanik, hekurkthyes, karpentier, specialist gjelbërimi dhe sinjalistike..etj). Makineritë e nevojshme që do të përdoren (për të cilat ky operator ndër të tjera ka deklaruar se disponon në pronësi 8 mjete për pastrimin e borës nga të cilat 3 me shnek dhe 5 me agregat) duke tejkualuar kërkesat e autoritetit lidhje me disponueshmerin e mjeteve për realizimin e kësaj kontrate, ka deklaruar kryerjen e operacioneve rutinë të mirëmbajtjes ku për këtë BOE deklaroi se do të dhe të operacioneve të riparimit të segmenteve rrugorë, ku sasia dhe tipologjia e elementeve do të përzgjidhen nga personeli përgjegjës për të kryer një punë në formën më optimale dhe të sigurtë të mundëshme. Plani i mobilizimit i cili do të jetë në dy nivele nivel qendror dhe nivel kantieri. BOE ka dhënë një përshkrim të materialeve që nevojiten për angazhim, në periudhën e mirëmbajtjes së objektit dhe asaj operacionale të riparimit të rrugëve, ku sasia dhe tipologjia e elementeve do të përzgjidhen nga personeli përgjegjës për të kryer një punë në formën më optimale dhe të sigurtë të mundëshme. Përshkrim të udhëzimeve janë parashtruar, për zgjidhjen e problemeve, të cilat kanë për qëllim të jenë një referencë e shpejtë për të ndihmuar profesionistët e mirëmbajtjes që të kuptojnë disa probleme të zakonshme në rrugë dhe t'i drejtojnë ato në seksionet përkatëse, gjatë fazës së mirëmbajtjes. BOE ka dhënë një përshkrim mbi ndjekjen e standardeve gjatë mirëmbajtjes, përshkrim mbi aktivitetet e mirëmbajtjes rutinë (sipërfaqet e pjerrëta, tombinot, muret mbajtës, shtresat asfaltike, urat dhe mbikalimet, mirëmbajtja e sinjalistikës rrugore, list kontrolli, operacionet e dimrit). Në përfundim, nga analizi i metodologjisë së dorëzuar nga ana e BOE “Ndërtues 2014” Shpk & “Varaku E” Shpk, rezulton se *prima facie* metodologjia e propozuar përmban përgjithësisht, të gjithë elementët e kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor, duke përmbushur kërkesat e termave të referencës. Në përfundim, nga analizi i metodologjisë së dorëzuar nga ana e BOE “Ndërtues 2014” Shpk & “Varaku E” Shpk, rezulton se *prima facie* metodologjia e propozuar përmban përgjithësisht, të gjithë elementët e kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor, duke përmbushur kërkesat e termave të referencës. Nga ana tjetër, KPP, referuar edhe proces-verbaleve të vlerësimit të ofertave nga ana e autoritetit kontraktor nuk është dhënë asnjë shpjegim teknik i detajuar, mbi arsyen e vlerësimit me 15 nga 15 pikë maksimale të cilësisë/metodologjisë për këtë bashkimë operatorësh ekonomikë. Gjithashtu edhe nga ana e BOE “Ndërtues 2014” Shpk & “Varaku E” Shpk për sa i përket propozimit teknik për metodologjinë e cilësisë në lidhje me garancinë e punimeve të rehabilitimit dhe çdo aktivitet tjetër lidhur me të, Komisioni konstaton se, në materialin e ngarkuar nga ky BOE në sistemin e prokurimeve elektronike nuk kemi asnjë të dhënë apo material të përshkruar në këtë propozim teknik.

Nga ana tjetër, parë në rrafsh krahasimor, metodologjia e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK, përbëhet nga:

- Cilësia
- Plani Manual Cilësisë për shërbimin e mirëmbajtjes;
- Plani operacional i mirëmbajtjes;
- Manual i menaxhimit të trafikut mirëmbajtja;
- Manuali jetës dhe shëndetit mirëmbajtja;
- Deklaratë për cilësinë;
- Godina e mirëmbajtjes;

Konkretisht, nga analizimi i metodologjisë së dorëzuar nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimes “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK, rezulton se prima facia metodologjia e propozuar përmban përgjithësisht të gjithë elementët e kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor, e cila përfshin metodat e përdorura, personelit kryesor, disponueshmërisë së pajisjeve kryesore, organizimi i stafit, siguria, sigurimit të cilësisë, planit të mobilizimit, garancia e punimeve të rehabilitimit dhe aktivitetet e tjera. Në rastin konkret, nga ana e BOE “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK, në përbushje të kriterit të “Cilësisë” është paraqitur në SPE një material prej 24 faqësh “Metodologjia Cilësia”, ku evidentohet:

- Objektivat e mirëmbajtjes së akseseve rrugore në Bogë-Theth ku do të ofrohet siguria e lëvizjes për gjatë gjithë gjatësinë e aksit, përmirësimi i aksesit për turizmin duke siguruar lidhjen e lehtë dhe të sigurt për turistët që vizitojnë zonat e pasura natyrore dhe kulturore të Bogës dhe Theth. Mbrojtjen e infrastrukturës kontraktori, me anë të metodologjisë së përshkruar si më lartë, monitoron, menaxhon dhe ndërmerr hapat për mbrojtjen e akseve që ka në inventar, si dhe planifikon më tej minimalizimin e këtyre ngjarjeve duke rritur kështu cilësinë e qarkullimit në zonë si dhe zhvillimin ekonomik të rajonit.

-Plani i mobilizimit ku përfshin mobilizimi i personelit dhe pajisjeve: Në momentin e nevojës, stafi dhe pajisjet janë të gatshme të lëvizin dhe të intervenojnë shpejt, për të realizuar mirëmbajtjen dhe për të siguruar që rruga mbetet kalueshme në çdo moment. Angazhimi i burimeve për emergjencë: Në rast të motit të keq ose bllokimeve të papritura, është e rëndësishme që burimet (pajisjet dhe stafi) të jenë të disponueshme për një reagim të menjëhershëm. Ne si kompani kemi investuar duke blerë godinen që ka sherbyer përpara viteve 2000 si godina e mirëmbajtjes ku ka qene zyre dhe pike takimi për ekipet e mirëmbajtjes, kjo godine të shërbejë si qendër për monitorimin e mirëmbajtjes së rrugëve. Godina ka nevojë për rikonstrukcion dhe ka një pozicion gjeografik strategjik në lidhje me mirëmbajtjen e këtij aksi pasi është 27 km nga fshati Razem, 26 km nga Thethi dhe 22 km nga Kopliku, pra një barazlargesi nga të gjitha pikat ekstreme të lotit në fjalë. Këtu do dislokohen mjetet dhe materialet e nevojshme për kryerjen e mirëmbajtjes dimerore që do fillojë mobilizimin që në shtator Gjithashtu kjo godine do jetë edhe si qendër e monitorimit për situatën në kohe reale të të gjitha akseve “Koplik - Bogë, Bogë - Theth, Dedaj – Razëm. Në krah të godines ne do të ndërtojmë një kabanon i cili do jetë për vendosjen e kripes si dhe për remontin

e makinerive dhe cdo gje qe eshte ne funksion te mbarevajtjes se mirembajtjes rutine si dhe punimeve te rehabilitimit ne keto akse.

- organizimi i stafit grupi kryesor i stafit është i organizuar në kater grupe: - Një për mirëmbajtjen rutinë; - Një për mirëmbajtjen dimërore; - Një për punimet e rehabilitimit dhe - Një për punimet e emergjencës. Çdo grup është përgjegjës për një lloj aktiviteti, si pastrimi i borës, riparimi i asfaltit, ose mbikëqyrja e sigurisë. Ata janë të organizuar në ekipe të vogla që janë të trajnuara për të menaxhuar dhe realizuar detyra të caktuara sipas nevojës. Gjithashtu BOE zotohet se do te investoj ne krijimin e qendres se monitorimit te mirembajtjes e cila do te jete ne Boge ku do te vendoset stafi menaxherial si dhe makinerite nga ku do te nisen te gjitha operacionet e mirembajtjes dimerore, rutine, emergjencat apo punimet e rehabilitimit.

-një përshkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve që do të anagazhohen në mirëmbajtje rutinë edhe dimërore, dhe të operacioneve të riparimit të segmenteve rrugorë, Makina për pastrimin e borës: Makina të specializuara me blade (thika të pastrimit) përdoren për të hequr borën dhe për të siguruar kalueshmërinë e rrugës. Këto makineri janë të pajisura gjithashtu me shpërndarës për kripë dhe rërë, për të parandaluar ngrirjen. Makina për riparimin e rrugës: Makinat e riparimit të asfaltit (si makineritë për mbushjen e gropave) janë thelbësore për të siguruar një sipërfaqe të sheshtë dhe të qëndrueshme për rrugën. Pajisje mbrojtëse për punonjësit: Pajisje si helmetat, dorezat, veshjet e sigurisë dhe këpucët e forta janë të domosdoshme për mbrojtjen e personelit gjatë punës në kushte të rrezikshme (si ngrirje, bllokime të borës dhe përdorimi i mjeteve të rrezikshme). Makinerite jane ne pronesi dhe jo me qera. Pervec atyre qe jane kerkuar ne dst, ne do sjellim per objektin edhe 3 borepastruese te tjera shtese qe do jene ne funksion te kesaj kontrate te cilat do jene me shneke (per hedhjen e debore) si dhe me rruspen shtyrese. Ne total do jene 5 mjete borepastruese me shperndares kripe qe do mbulojne gjithe aksin prej 67.3 km.

-një përshkrim të planit për sigurimin e cilësisë, ofertuesi BOE “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK zotohet për kontrollin e të gjitha materialeve të përdorura për ndërtimin dhe mirëmbajtjen duhet të kontrollohen për cilësinë e tyre. Përdorimi i materialeve të aprovuar dhe me standarde të certifikuara garanton që punimet do të jenë të qëndrueshme dhe të sigurt. Do të realizohet mbikëqyrja e punimeve pas çdo faze të punës, inxhinierët dhe specialistët teknikë kryejnë inspektime për të vlerësuar cilësinë e realizuar dhe për të siguruar që gjithçka është sipas projektit. Materialet që do përdoren nga ne do të pajtohen me kriteret e cilësisë sic janë përshkruar në Rregullin Teknik të Projektimit dhe Ndërtimit të Rrugëve. Ne do të kryejmë testet laboratorike të nevojshme për të përcaktuar cilësinë e materialeve. Gjithashtu, BOE “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK ofron nje garanci per punimet e rehabilitimit prej 7% (shtatë përqind) te vleres se punimeve te rehabilitimit per certifikim punimesh, per nje periudhe 36 (tridhjetë e gjashtë) muajsh nga momenti i certifikimit te perkohshem te punimeve te rehabilitimit.

- Për shkak të natyrës së shërbimeve, siguria është një prioritet i lartë për të minimizuar rreziqet që lidhen me punimet dhe për të mbrojtur jetën dhe shëndetin e personelit dhe kalimtarëve. Përdorimi i pajisjeve mbrojtëse personale është detyrë për çdo punonjës. Kjo mbrojtje përfshin gjithashtu sigurimin e kushteve të punës që nuk do të shkaktojnë dëme për shëndetin. Përpara çdo aktiviteti, do bëhet një analizë për rreziqet që mund të lindin, si rrëshqitje në rrugë të ngrirë,

bllokime të papritura dhe kushte të tjera që mund të rrezikojnë sigurinë e punonjësve. Gjithashtu sa i përket sigurisë ne do të vendosim tabela sinjalizuese elektronike (lajmerimin e mjeteve që do levizin në aks për kohën dhe gjendjen e rruges si dhe në çfarë niveli kalueshmërie do jete rruga dhe sa kohë mund të doje për zhbllokimin e plote të trasës së rruges) në katër pika të ndryshme të gjatësisë së aksit të mirëmbajtjes. Duke qenë se burimet njerzore janë aseti më i çmuar, atëherë shëndeti dhe siguria në punë merr një rëndësi të vecantë gjatë punës së shoqërisë tonë. B.O.E “Rroku Guest” & “Deha 2010” do të bëjë orientimin e duhur dhe trajnimet, do të vlerësojë përmbajtjen e kurseve të trajnimit të Shëndetit & Sigurisë në punë dhe gjithë materialet e përdorur / shpërndarë dhe kontrolluar përpara ekzekutimit. Trajnimi do të përfshijë temat në vijim: sinjalistika rrugore; rreziqet dhe masat paraprake; rreziku ndaj zhurmës; rreziku i pajisjeve rrotulluese; rreziku i temperaturës së lartë dhe presionit; siguria ndaj pajisjeve elektrike; trajtimi mbi substancat e rrezikshme; hapësira e kufizuar; puna në lartësi; zjarr / rrezik shpërthimi; parandalimin e zjarrit dhe luftimin e zjarrit; mbrojtjen e mjedisit; emergjencat. Për këtë arsye është hartuar një Plan i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë, i cili përmban instruktimin teknik të stafit të shoqërisë në varesi të llojit të punës dhe sidomos instruktimin për punimet në rrugë, kontrolli dhe menaxhimi i trafikut rrugor si dhe montimi i sinjalistikës rrugore (vertikale dhe horizontale) ku përfshihen masat për kontrollin e duhur të trafikut siç nevojitet apo kërkohet nga Mbikqyrësi, ka parashikuar të vendosë personat me flamur ose semafor levizës, detyra e të cilëve do të jetë të drejtojnë lëvizjen e trafikut përmes ose anash punimeve. Me qëllim minimizimin e ndërprerjes së trafikut, nga stafi shoqërisë parashikohet të mbyllet me gardh përkohësisht pjesa e sheshit të ndërtimit, siç nevojitet për të siguruar një barrierë vizive midis zonës së punimeve dhe trafikut të afërt. Në lidhje me metodat e përdorura është përcaktuar edhe metodologjia e punimeve të mirëmbajtjes ku përfshihen masat konkrete mbi mirëmbajtjen rrugore dimërore, mbi mirëmbajtjen rrugore rutinë, përshkrim të punimeve të rehabilitimit + periodike të detajuara sipas detyrave respektive, ku përfshihen: Pastrimi i kanaleve dhe kunetave, Mbushja dhe nivelimi i bankinave, Pastrimi i vegjetacionit, Pastrimi i karrexhatës nga aluvionet dhe materiale të tjera, Riparimi i gropave të asfaltit, Mbushje dhe profilim i nënshtresave në rrugët me asfalt, Riparimi dhe rifreskimi i sinjalistikës horizontale, Riparimi dhe rifreskimi i sinjalistikës vertikale, pajisjeve të sigurisë rrugore (mbrojtëset metalike), masat konkrete për Mirëmbajtje rutinë e veprave të artit, masat konkrete për Punimet e mirëmbajtjes Dimërore. -Çdo projekt i punimeve të rehabilitimit do të jetë i kontrolluar dhe i sigluar nga një auditues i certifikuar i sigurisë rrugore. Grafiku jep informacion në lidhje me punët që do kryhen si dhe kohën kur do fillojë e përfundojë punimi i rehabilitimit. Për përpilimin e grafikut të punimeve, stafi teknik i shoqërisë ka marrë në konsideratë kushtet e rruges, të metat që ajo paraqet, ndikimin që këto të metat kanë në gjendjen e rruges dhe se si ndikojnë ato drejtuesi i mjetit, nevojën emergjente që kanë këto të metat për tu riparuar si dhe kushtet klimatike që priten në vazhdim të zbatimit të kontratës. - dhe punimet e emergjencës, janë punime që nuk mund të përcaktohen fillimisht por që mund të ndodhin gjatë kohëzgjatjes së kontratës si fenomene të paparashikueshme stuhi shiu me kohezgjatje e sasi të mëdha, termete, rrëshqitje, cedime etj. Përse i përkete punimeve emergjente, nga ana e stafit teknik janë në vëmendje fenomenet natyrore që mund të shkaktojnë dëme të mëdha dhe si rrjedhojë punime

emergjente për riparimin e këtyre detyrës. Në përfundim, nga analizimi i metodologjisë së dorëzuar nga ana e BOE “Rroku Guest” Shpk & “Deha 2010” Shpk, rezulton se *prima facie* metodologjia e propozuar përmban të gjithë elementët e kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor, duke përmbyllur kërkesat e termave të referencës.

Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, ndonëse vlerësimi me pikë (në rastet kur nuk aplikohet përlllogaritje me formulë) megjithëse bazohet në gjykimin personal dhe individual të secilit prej anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave (KVO), brenda diapazonit me pikë, të përcaktuar në dokumentet e tenderit, por nga ana tjetër ky vlerësim dhe gjykim, nuk duhet të jetë subjektiv, por i bazuar dhe arsyetuar mbi dokumentacionin e paraqitur nga secili operator ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, Komisioni, gjykon se, procesi i pikëzimit, duhet të bëhet në përputhje dhe në proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga secili ofertues, i cili, nga ana tjetër, duhet të jetë sa më afër kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Fryma e ligjit të prokurimit publik, është e tillë që, çdo operator duhet të përgatisë ofertën e tij në përputhje me kriteret dhe kërkesat e parashikuara në dokumentet e tenderit. Në lidhje me vlerësimin e pikëve për këtë kriter, nga shqyrtimi i proces-verbalit të argumentimit të vlerësimit të bërë nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, si edhe analizuar në rrafshin krahasimor të dy propozimeve teknike për cilësinë, e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të kualifikuar në fazën e dytë, si edhe të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimes në raport me operatorin tjetër të kualifikuar, në lidhje me kriterin e faktorit “cilësia”. Në fazën e dytë të vlerësimit Komisioni i Vlerësimit të ofertave ka vlerësuar me pikët maksimale nga 15 pikë secilin nga pjesëmarrësit. Në analizë të thelluar dhe parë në rrafshin krahasimor, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e BOE “Ndërtues 2014” Shpk & “Varaku E” Shpk, është paraqitur një metodologji e përgjithshme të cilësisë në përmbyllje të elementëve të propozimit teknik të kërkuar nga autoritetit kontraktor, në krahasim me metodologjinë e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK i cili ka marrë në konsideratë edhe elementët specifikë të kryerjes së shërbimit që lidhen me vetë kushtet e kontratës ku evidentohet elementi i instalimit të kamerave në aksin rrugor në të cilin do të realizohet shërbimi, instalimi i tabelave informuese për përdoruesit e rrugës në katër pika të ndryshme të segmentit rrugor të cilat do të sinjalizojnë përdoruesit në lidhje me aksesueshmërinë e rrugës, si dhe një garanci për punimet e rehabilitimit prej 7% (shtatë përqind) të vlerës së punimeve të rehabilitimit për certifikim punimesh, për një periudhë 36 (tridhjetë e gjashtë) muajsh nga momenti i certifikimit të përkohshëm të punimeve të rehabilitimit.

Ndaj si rrjedhojë e konstatimeve të sipërcituara nga analizimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatorët ekonomik pjesëmarrës për këtë kriter, autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për ripërlllogaritjen e pikëve për secilin ofertues pjesëmarrës të kualifikuar në sistemin e prokurimeve elektronike në përputhje me dokumentacionin e dorëzuar. Procesi i pikëzimit në procedurat e shërbimeve me performancë, duhet të bëhet në përputhje dhe në proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga secili ofertues, i cili nga ana tjetër duhet të jetë sa më afër kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Fryma e LPP është e tillë që çdo

operator duhet të përgatisë ofertën e tij në përputhje me kriteret dhe kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, është e vërtetë se, vlerësimi me pikë bazohet në gjykimin personal dhe individual të secilit prej anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave, brenda diapazonit me pikë të përcaktuar në dokumentat e tenderit, por, nga ana tjetër, ky vlerësim dhe gjykim, nuk duhet të jetë subjektiv, por i bazuar dhe arsyetuar mbi dokumentacionin e paraqitur nga secili operator ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

Për sa më sipër pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK qëndron.

III.2.12. Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social [0-5 pikë]

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një metodologji të qartë për minimizimin e ndikimit në mjedis të veprës si dhe propozimet e tij për menaxhimin e riskut mjedisor dhe social (sipas Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe Social (VNMS). Vlerësimi i pikëve për këtë kriter do të realizohet sipas përshkrimit të mëposhtëm të ndarë sipas nën-kritereve.

- a. Propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike (miqësore me mjedisin) / të ricikluara / efikente / materiale që minimizojnë ndikimin mjedisor. Përdorimi i makinerive / pajisjeve ekologjike. Hartimi i një plan propozimi të menaxhimit dhe kontrollit të minimizimit efekteve mjedisore. [0 - 3 pikë]
- b. Propozime konkrete për përmirësime të ekonomisë lokale të zones ku kryhet shërbimi si një iniciative sociale e ofertuesi nëpërmjet punësimeve. [0 - 2 pikë]

Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga secili ofertues dhe si edhe vendimit të Komisionit të shqyrtimit të ankesave, Komisioni konstaton se operatorët ekonomikë pjesëmarrës kanë dorëzuar secili ofertues, në rastin konkret BOE “Ndërtues 2014” Shpk & “Varaku E” Shpk, një material prej 19 faqësh, ku kemi një përshkrim i përgjithshëm i kuadrit ligjor mjedisor shqiptar si dhe qëllimi i planit të menaxhimit mjedisor, një përshkrim të procedurave të zbatuara nga kompania për zbutjen e efekteve negative, procedurat e monitorimit, auditim i zbatueshmërisë së sistemit të menaxhimit mjedisor dhe social, një përshkrim checklist mbi procedurat e menaxhimit të çështjeve sociale i cili përfshin konsultimi dhe informimi i publikut, mbrotja e trashëgimis kulturore, angazhimi i palëve të interesit, takimet publike dhe procedura e menaxhimit të ankesave. Në këtë raport vihet re një përshkrim i përgjithshëm duke përshkruar ndikimet ndaj nivelit social, ajrit, zhurmave, ujit, florës, faunës, peisazhit dhe zonat e mbrojtura. Në raport vihet re një përshkrim i masave të propozuara për mbrojtjen e mjedisit, plani i menaxhimit të mbetjeve të rrezikshme dhe jo të rrezikshme.

Referuar informacionit të kërkuar nga autoriteti kontraktor mbi Propozimet për uljen e ndikimit në mjedis dhe ndikimin social për sa i përket Propozime konkrete për përdorimin e materialeve

ekologjike, Përdorimi i makinerive/pajisjeve ekologjike dhe Propozime konkrete për përmirësime të ekonomisë lokale të zonës ku do të kryhet shërbimi si një iniciative sociale e ofertuesi nëpërmjet punësimeve, Komisioni konstaton se, nuk kemi asnjë të dhënë apo material nga ana e BOE.

Ndërsa, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues “Rroku Guest” SHPK SHPK & “Deha 2010” SHPK ka dorëzuar një material prej 14 faqësh “*Propozimi për Uljen e Ndikimit në Mjedis dhe ndikimi social*”, si dhe dokumentin prej 27 faqësh “*Menaxhimi Mjedisor dhe Social*” ku kemi një përshkrim i përgjithshëm i kuadrit ligjor mjedisor shqiptar si dhe qëllimi i planit të menaxhimit mjedisor, një përshkrim të projektit (ku evidentohet vendndodhja, bimësia, mjedisi), një përshkrim të planit konkret mbi monitorimin mjedisor dhe social (PMMS) ku evidentohen edhe masat lehtësuese, një përshkrim të përdorimit të materialeve të riciklueshme dhe i pajisjeve/makinerive të transportit sic është atovetura me bateri i deklaruar për transportimin e punonjësve, si dhe përdorimi i mjeteve/pajisjeve me konsum të ulët karburanti në mënyrë që të clirohet sa më pak ndotje në mjedis, përdorimi i energjise së rinovueshme nga panelet diellore për disa nga proceset e punës. Gjithashtu gjatë punimeve do të përdoren filtra dhe pajisje për të ulur pluhurin dhe ndotjen e ajrit. Një përshkrim të ndikimeve të parashikuara mjedisore (tokë, ajër, ujë, zhurmë, mebtje inerte), të projektit dhe gjithashtu ka ofruar masa të përgjithshme zbutëse për të minimizuar nëse jo eliminuar ndikimet potencialisht negative, në mënyrë që të sigurohet që ndërhyrjet sipas projektit të propozuar të mos shkaktojnë ndikime mjedisore përtej nivelit të pranueshëm. Pa përfundimit të punimeve do të bëhet rehabilitimi i zonave të dëmtuara nga ndërtimi duke mbjellë bimë vendase në mënyrë që të rikthehet ekosistemi dhe të mbrohet biodiversiteti. Gjithashtu BOE ankimues ka paraqitur një përshkrim dhe propozim për marrjen e disa masave për përmirësimin e impaktit social: ku nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se BOE ankimues një pjesë të madhe të stafit e ka të banues të zonës Bogë dhe Thethë, si dhe zotohet se do të punësojë edhe pesë punonjës të tjerë që banojnë në këto zone me saktësi në Theth dhe në Boge për zhvillimin e punimeve gjatë zbatimit të kontratës. Gjithashtu banorët e zonave përreth do të përfshihen në diskutimet dhe vendimmarrjet lidhur me ndihmën që mund të ofrojnë ky projekt për ta. Kjo do të bëhet përmes takimeve të rregullta dhe konsultimeve publike për të siguruar transparencë dhe për të marrë parasysh nevojat e tyre, në mënyrë që aksesin të mos jete vetëm për rrugët kryesore, por edhe për hyrje daljet e bizneseve/shtepiave. Sic është theksuar më lart janë krijuar mundësi për lokale për banorët gjatë mirëmbajtjes së aksit rrugor, dhe gjithashtu do të mbështetet zhvillimi i aktiviteteve bujqësore dhe të blegtorisë, të cilat mund të përfitojnë nga lehtësira nga infrastruktura së re. Mund të realizohet edhe ndërtimi i korsive të sigurisë për këmbësorët dhe biçiklistët.

Në lidhje me këtë kriter kemi në fillim I-nënkriterin Propozime konkrete për përdorimin e materialeve ekologjike (miqësore me mjedisin) / të ricikluara / efikente / materiale që minimizojnë ndikimin mjedisor. Përdorimi i makinerive / pajisjeve ekologjike. Hartimi i një plani propozimi të menaxhimit dhe kontrollit të minimizimit efekteve mjedisore të përcaktuar në dokumentet e tenderit me 0-3 pikë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK janë përcaktuar dhe përshkruar masat që do të ndërmarrë gjatë zbatimit të projektit për minimizimin e ndikimeve në mjedis si dhe është specifikuar materialet të cilat do të përdoren do të jenë të riciklueshme sic është betoni me përbërës

të ricikluar, përdorimi i teknologjise së avancuar në mjete dhe pajisje me qëllim uljen e emetimit të CO₂, dhe përdorimi i energjisë diellore kur është e mundur për pajisjet dhe mjetet në kantieret e mirmëbajtje, ndërkohë referuar dokumentacionit të dorëzuar nga BOE “Ndërtues 2014” Shpk & “Varaku E” Shpk, është paraqitur hyrja, qëllimi i projektit, si dhe një përshkrim i përgjithshëm i kuadrit ligjor. Në këtë raport, vihet re një përshkrim i përgjithshëm i projektit kryesisht për hapat që ndiqen gjatë mirëmbajtjes së rrugeve, si dhe përshkrim i përgjithshëm i komponentëve të mjedisit si flora, fauna, ajër, ujë dhe klima, ndikimi i aktivitetit të zhvillimit të projektit në komponentët mjedisorë si dhe masat rehabilituese. Në këtë raport vihet re një përshkrim i përgjithshëm duke përshkruar ndikimet ndaj nivelit social, ajrit, zhurmave, ujit, florës, faunës, peisazhit dhe zonat e mbrojtura.

Në lidhje me këtë kriter kemi në fillim II-nënkriterin Propozime konkrete për përmirësime të ekonomisë lokale të zonës ku zhvillohet projekti si një iniciative sociale e ofertuesit nëpërmjet punësimeve të përcaktuar në dokumentet e tenderit me 0-2 pikë. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga ankimuesi, konstatohet se bashkimi i operatorëve ekonomikë “Rroku Guest” Shpk & “Deha 2010” SHPK ka paraqitur propozime konkrete të tilla si punësim të banorëve të zonës përreth ku do të zhvillohet projekti. Për sa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka gjykuar, që të dy ofertuesit e kualifikuar të vlerësohen për këtë kriter me nga 4 pikë respektivisht secili. Për të dy nënkriteret e sipërcituara, referuar dokumentacionit të dorëzuar nga secili ofertues BOE “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK dhe BOE “Ndërtues 2014” Shpk & “Varaku E” Shpk, Komisioni konstaton se nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës janë paraqitur materiale për propozimet për uljen e ndikimit në mjedis. Ata në materialet e tyre respektivë, kanë përcaktuar dhe përshkruar masa të përgjithshme që do të ndërmarin gjatë kryerjes së shërbimit të mirëmbajtjes rutinë/dimërore, operacioneve të rikonstruktimit të rrugëve si dhe për minimizimin e ndikimit në mjedis në zonën ku do të zhvillohet objekti.

Gjithashtu, kanë hartuar masa për menaxhimin mjedisor, masa për menaxhimin e mbetjeve, haat e prprocesit të monitorimit, etj. Nërsa, një vlerë e shtuar nga ofertuesi BOO “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK janë paraqitur propozime për përmirësime të ekonomisë lokale të zonës gjatë kryerjes së shërbimit në lidhje me punësimin e banorëve të zonës. Inovatore është edhe procedura e menaxhimit të mbetjeve, apo përdorimi i teknologjive në lidhje me uljen e ndikimit në mjedis, si përdorimi i energjisë së rinovushme diellore, përdorimii makinerive/pajisjeve me me konsum të ulët karburanti dhe emetim të ulët do të ndihmojë në reduktimin e ndotjes nga ndërtim. Përdorimi i filtrave dhe pajisjeve për të ulur pluhurin dhe ndotjen e ajrit gjatë punimeve. Bazuar në këto propozime të dy operatorët janë vlerësuar secili me nga 4 pikë, për të dy nënkritere sëbashku. Në këtë kontekst, Komisioni gjykon se, vlerësimi i KVO-së për këtë komponent të rëndësishëm të propozimit mjedisor dhe social, nuk është mirëargumentuar në përputhje me materialet e paraqitura prej secilit ofertues, ndërsa pretendimi i operatorit ekonomik ankimues për një vlerësim maksimal për këtë komponent rezulton të jetë i bazuar, parë kjo në rrafshin krahasimor të parashtruar më lartë në argumentim. Komisioni gjykon se vlerësimi i kryer nga KVO nuk është kryer në përputhje me dokumentacionin e paraqitur nga ankimuesi, një vlerësim që nuk është mirëargumentuar në detaje, për të cilin Komisioni gjykon se, autoriteti kontraktor duhet të marrë

masa dhe të kryejë rivlerësimi me pikë me diferencë midis ofertuesëve të kualifikuar në këtë fazë të dytë. Procesi i pikëzimit në procedurat e shërbimeve me performancë, duhet të bëhet në përputhje dhe në proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga secili ofertues, i cili nga ana tjetër duhet të jetë sa më afër kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Fryma e LPP është e tillë që çdo operator duhet të përgatisë ofertën e tij në përputhje me kriteret dhe kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, është e vërtetë se, vlerësimi me pikë bazohet në gjykimin personal dhe individual të secilit prej anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave, brenda diapazonit me pikë të përcaktuar në dokumentat e tenderit, por, nga ana tjetër, ky vlerësim dhe gjykim, nuk duhet të jetë subjektiv, por i bazuar dhe arsyetuar mbi dokumentacionin e paraqitur nga secili operator ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

Për sa më sipër pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK qendron.

III.2. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomik ankimues “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së bashkimit të operatorëve ekonomikë “Ndërtuesi 2014” SHPK & “Varaku E” SHPK, në procedurën e prokurimit objekt ankimi si ofertë anomalisht e ulët me arsyetimin se *“Kemi indicie që jemi në kushtet kur oferta anomalisht e ulët nuk duhet pranuar nga Autoriteti Kontraktor, pasi nuk plotëson 5 kushtet referuar Nenit 93 të ligjit të prokurimit publik kur: Oferta anomalisht e ulët. Kemi indicie dhe dyshime që oferta e shpallur fituese nuk respekton detyrimet e zbatueshme nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në FUSHËN SOCIALE DHE TË PUNËS e të akteve të tjera, më konkretisht nuk plotëson V.K.M Nr. 113, datë 1.3.2023 “PËR PËRCAKTIMIN E PAGËS MINIMALE NË SHKALLË VËNDI”, ku paga minimale neto orare duhet të jetë 229.9 lekë/orë dhe bruto 301.63 lekë/orë. Gjithashtu duhet vlerësuar që një pjesë e madhe e punimeve të rehabilitimit kërkojnë punëtori të specializuar dhe jo punëtori të thjeshtë. Rikujtojmë që struktura e preventivit të rehabilitimeve në raport me orët e punës nuk duhet ndryshuar pasi konsiderohet ndërhyrje në ofertë. Gjithashtu bazuar në nenin 93 të ligjit të prokurimit publik pika 2.a anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit; Operatori ekonomik ofertues do duhej të dorëzonte faturat tatimore për të justifikuar cmimet e materialeve dhe arsyet pse i ka ato cmime aq të ulëta, nëse nuk ka dorëzuar FATURA TATIMORE, dhe jo oferta dhe dokumente të tjera që nuk kanë vlerë, nuk plotësohet kushti 2.a i nenit 93 të ligjit të Prokurimit Publik. Për këtë arsye ne kërkojmë skualifikimin e ofertës së B.O.E “Ndertuesi 2014” shpk & “Varaku E” shpk si anomalisht e ulët e cila nuk i plotëson 5 kushtet referuar nenit 93 të Ligjit të Prokurimit Publik.”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor dorëzuar pranë KPP me shkresën nr. 130/1 protokollin datë 09.01.2025 protokolluar me tonën me nr. 3781/6 prot datë 13.01.2025 me objekt

“Shkresë përcjellëse”, rezulton se përveç aktit të trajtimit të ankesës së bashkimit të operatorëve ekonomik ankimes është dërguar gjithashtu edhe arsyetimi i ofertës anomalisht të ulët nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Ndërtuesi 2014” SHPK & “Varaku E” SHPK.

Bazuar ne kërkesen tuaj te mbërritur prane nesh nepermjet faqes se app me date argumentimin ekonomik te ofertes tone si dhe 13.12.2024, po ju paraqesim analizat e cmimeve per te gjithë elementet perberes te preventivit te pjeses se rehabilitimit, ne lidhje me proceduren e prokurimit te zhvilluar me date 11.12.2024 nga AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR me objekt "Loti 2: Mirëmbajtje me performancë rruga "Koplik - Bogë, Bogë - Theth, Dedaj - Razëm" (gjatësia totale 67.3 km)" me fond limit 329,552,917 (treqind e njëzet e nëntë milion e pesëqind e pesëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e shtatëmbëdhjetë) Lekë pa TVSH.

Ne lidhje me oferten e paraqitur nga shoqëria jone sqarojme se ofrojme nje zgjidhje teknike te ofertes, bazuar ne disa faktor si vijon:

Se pari, kemi burimet e mjaftueshme financiare per te realizuar objektin e tenderuar.

Se dyti, subjekti ka eksperience shume te gjere ne fushen e punimeve te se njeites natyre me objektin e prokuruar nga ana juaj , me aktivitet qe nga viti 2014. Gjate kesaj periudhe kemi realizuar me sukses te plote disa mirembajtje rutine me performance duke perfshire segmentet Boge Theth, Tamare - Vemrosh, Rruga e Velipojes, Rruga e Komanit, Rruga e Bushatit, Rruga e Shirokes. Po ashtu kemi ndertuar dhe rikonstruktuar disa rruge te ndryshme ne qytete te ndryshme te Shqiperise. Per here te pare ne historine e shtetit shqiptar, kemi arritur te mbajme te hapur gjate periudhes se dimrit segmentin rrugor Shkoder - Theth. Ku ne kete segment perfshihet edhe rruga me larte automobilistik ne ballkan (Qafa e Thores).

Se treti, ne kemi ne stafin tone drejtues teknik te profesioneve te ndryshem si Ing. Ndertimi, Ing. Topograf, Ing. Mjedisi, Ing. Hidroteknik, Ing. Gjeolog, Ing. Mekanik dhe specialist te ndryshem te certifikuar si Manovrator, Shofer, Teknik Ndertimi, Karpentier, Asfaltoshtrues, qe perbejne nje garanci te mjaftueshme per realizimin e objektit te prokurimit. Po ashtu do te angazhohen edhe specialiste te tjere nese eshte e nevojshme.

Se katerti, ne kemi marreveshje bashkepunimi me furnitor te ndryshem qe ne teresi prodhojne dhe tregtojne pjesen kryesore te zerave te preventivit te procedures se prokuruar. Para dhenies se ofertes kemi marre edhe oferte perkatese sic eshte ajo qe do bashkangjitet ketij argumentimi, konkretisht ajo nga kompania “Boris 2019” sh.p.k.

Se pesti, per te provuar zgjidhjen teknike te propzuar nga ana jone eshte bere nje studim i mirefillt segmentit objekt prokurimi, duke bere nje metodologji perkatese (Plan operacional per mirembajtjen, plan menaxhimi mjedisor dhe social, manual per menaxhimin e trafikut, plan per sigurimin e cilesise, plan per mbrojtjen e jetes dhe shendetit ne pune si dhe nje plan te posacem per menaxhimin e riskut eventual), te gjitha keto pjese integrale e dokumentave te ngarkuara ne SPE.

Se gjashti, pjesa kryesore e cmimeve te vendosura ne oferten tone jane mbi cmimet e manualit te cmimeve te ndertimit ne fuqi si dhe jane te analizuar me cdo element perkates.

Persa i perket pjeses se cmimeve qe jane nen cmimet e manualit jane analizuar ne menyre te posacme duke justifikuar cdo cmim sipas normave ligjore ne fuqi dhe duke paraqitur faturat e blerjes se materialeve qe jane pjese perberese e strukturese se kostos te cdo zeri te ofertuar. Fakti qe ne i kemi blere keto materiale me cmime me te uleta ne te kaluren tregon besueshmeri te plote per realizimin me sukses te kontrates. (bashkangjitur po ju dergojme edhe faturat e blerjes).

Nese do jemi fitues te kesaj procedure prokurimi do zbatohen me perpikmeri te gjitha rregullat e sigurimit teknik te percaktuara ne Kodin e Punes, do te zbatohen edhe te gjitha detyrimet per kategorite e punetoreve. Do bashkerendojme fuqine punetore te kualifikuar me realizimin ne cilesi shume te mire te sherbimit te kerkuar nga Autorileli Kontraktor.

Origjinaliteti i puneve tona vertetohet me ane te CV-se se shoqerise tone ne te cilen pasqyrohen objekte te realizuar sipas kerkesave te investitoreve pothuajse ne te gjitha vendet e Shqiperise (Shkoder, Tirane, Lezhe, Durres, Puke, Fushe Arrez, etj).

Nje element shume domethenes i ofertes eshte fakti se makinerite e kerkuara ne kete procedure prokurimi he te propozuara nga ana jone i kemi te gjitha ne pronesi.

Ajo qe vlen te theksohet eshte fakti se posedojme 8 borepastruese qe jane disponibel per tu perdorur ne kete objekt ku 5 prej tyre jane te pajisura me shnek gje kjo qe lehteson ne maksimum realizimin e ketij sherbimi.

Referuar statusit te subjektit dhe eksperiences se tij disa vjecare kemi akses te plote per te marre ndihme shteterore duke qene se jemi treguar shume korrekt me te administrates shteterore. Po ashtu kemi edhe mundesi gjitha institucionet financimi nga bankat e niveleve te dyta. Por per rastin konkret nuk e kemi fare te nevojshme marrjen e ndihmes shteterore pasi kemi mundesi ekonomike dhe kapacitete te tjera teknike dhe burime njerezore te mjaftueshme per te realizuar deri ne detaje kete kontrate eventuale.

Persa i perket anes ekonomike bazuar sa me siper, ne momentin e pergatitjes se ofertes eshte menduar qe fitimi eventual nga ana jone te jete fare minimal dhe objekti te realizohet ne kohen dhe cilesine e duhur.

Bashkangjitur Analizat Teknike te Cmimeve, Faturat e Blerjes dhe Ofertat.

III.2.2. Në nenin 93 “Oferta anomalisht e ulët” të ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon se:

1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.

2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:

- a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;
- b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;
- c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;
- ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;
- d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

3. Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj, duke marrë në konsideratë elementet e përmendura në pikën 2 të këtij neni.

Autoritetet ose entet kontraktore e refuzojnë ofertën kur konstatojnë se oferta është anomalisht e ulët, sepse nuk pajtohet me detyrimet e zbatueshme nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës e të akteve të tjera.

4. Nëse një autoritet kontraktor konstaton se një ofertë është anomalisht e ulët për shkak se ofertuesi ka marrë ndihmë shtetërore, oferta mund të refuzohet vetëm për këtë arsye, vetëm pas konsultimit me ofertuesin, nëse ky i fundit nuk mund të provojë, brenda një afati kohor të përcaktuar nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet të jetë të paktën 3 ditë pune, që ndihma është marrë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.2.3. Në nenin 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” pika 4 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikon se:

Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;

- Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore, sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93, të LPP-së.

III.2.4. Në seksionin I “Udhëzime për operatorët ekonomikë” të dokumenteve të procedurës së prokurimit, pika 26 “Vlerësimi i ofertave dhe korrigjimi i gabimeve aritmetike dhe ofertave anomalisht të ulëta”, nën-pika 2 parashikohet se: “2. Kur autoritetet /entet kontraktore vërejnë se oferta është anomalisht e ulët, i kërkojnë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin dhe në përputhje me dispozitat e këtij neni. - Në rast kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta konsiderohet anomalisht e ulët kur zvogëlohet më shumë se 25% të fondit limit të përlllogaritur. - Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta konsiderohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më pak se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Nëse një ose disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, para se të marrë një vendim për kualifikimin e tyre ose jo, në përputhje me nenin 93 të LPP-së. Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin / elementet specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.”.

III.2.5. Nga interpretimi literal i nenit 93 pika 1 të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave dhe në zbatim të VKM 285/2021 të ndryshuar. Gjithashtu, K.P.P. gjykon se argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative për ti dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor. Së pari, operatori ekonomik ankimues duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të ofruara si edhe në raste të veçanta dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve. Gjithashtu është detyrë e operatorëve ekonomikë oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi, si edhe së fundmi duhet të vërtetojë zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë, në fushën e mjedisit dhe fushën sociale, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi. K.P.P. gjykon se katër kushtet e mësipërme të parashikuara nga lex specialis janë kushte

kumulative të cilat më anë të provave shkresore dhe argumentimeve përkatëse duhen plotësuar nga operatorët ekonomikë ankimues, oferta e të cilëve rezulton anomalisht e ulët. Referuar nenit 93 pika 3 të LPP-së autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. K.P.P gjykon se nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangien e riskut që mund të sjellë një ofertë e cila rezulton anomalisht e ulët. K.P.P. gjykon se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime ku ndër të tjera si: rreziku për mos kryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kosto që i lindin autoritetit nga mos kryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga mos kryerja e shërbimit gjatë periudhës së ri publikimit të procedurës së tenderit në rast të mos zbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët. Gjithashtu, K.P.P. thekson se referuar nenit 1 gërma “b” “Objekti dhe qëllimi” i ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore, të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës që mund të vijnë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përlogaritjes të parashikuar në ligj. Sa më sipër, referuar rastit në fjalë dhe themelit të kërimit të operatorit ekonomik ankimues, KPP gjykon vetëm mbi dokumentet e dorëzuara pranë autoritetit kontraktor dhe në rast se këto të fundit përmbushin në mënyrë të detyrueshme katër kushtet e para kumulative të parashikuara nga neni 93 pika 2 i LPP-së, si dhe mundësinë për të përmbushur kushtin e pestë, mospërmbushja e të cilit nuk përbën shkak për dështimin e operatorit ekonomik në argumentimin e ofertës anomalisht të ulët.

III.2.6. Referuar ofertës së operatorit ekonomik të dorëzuar në procedurën e prokurimit objekt ankimi, si edhe në respekt të nenit 93 të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, të nenit 82 pika 4 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Rrregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar si edhe Udhëzimeve për Operatorët Ekonomikë të dokumenteve të procedurës së prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se oferta e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Ndërtuesi 2014” SHPK & “Varaku E” SHPK rezulton anomalisht e ulët. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se vërtet ligjvënësia ka lejuar paraqitjen e ofertave anomalisht të ulta por në cdo rast operatorët ekonomikë duhet të paraqesin në cdo rast prova bindëse për autoritetin kontraktor se nuk ka asnjë rezik për realizimin me sukses të kontratës me cmimin e ofertuar dhe se në këtë cmim janë të përfshira të gjithë elementët e koston të nevojshme dhe të detyrueshme për tu mbuluar. Në kuptim të ligjit për prokurimin publik dhe konkretisht nenit 93 të tij, në justifikimin e ofertave anomalisht të ulëta, operatorët ekonomikë

duhet të dëshmojnë se përmbushin 4 kushtet kumulative ku tre prej të cilave lidhen drejtpërdrejtë me metodën ekonomike të ndërtimit të ofertës së dorëzuar si edhe kushtet favorizuese që kanë operatorët ekonomikë të cilat kanë lejuar këtë të fundit, si edhe të ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi të paraqesin një ofertë e cila është anomalisht e ulët sipas formulës së përcaktuar si më sipër sqaruar.

Gjithashtu, referuar metodës së ndërtimit të ofertës ekonomike dhe kushteve favorizues të deklaruar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë është dorëzuar dokumentacion (fatura, oferta) që dëshmojnë kushte favorizues përsa i përketë bazës materiale të nevojshme për realizimin e shërbimit të mirëmbajtjes, ashtu sic është parashikuar edhe në preventivin e shërbimit si Punime Rehabilitimi, ku ndër të tjerat përfshihet edhe punime të sinjalistikës rrugore, “*me Tabele katrore normal me A=60, Tabela trekendore normal me A = 90, Tabele rrethi "detyrim" normal me D = 60, Tabela tetekendore normal me A-B, 90 - 30, Pervijues normal anesor, Pervijues modulare te kthesave, Pervijues modulare te kthesave (teke), Pervijues modulare te kthesave (çift), Pervijues kthese e ngushte ose e forte (ne forme T), FV tabela rrugore treguese 150x40cm, FV tabela te ndryshme rrugore D = 60cm, Vizime me boje bikomponente me gjeresi 15 cm, FV Bordura betoni, Gabiona me rrjete teli te zingua, F V hekur betoni i zakonshem Ø 6 ~ 10 mm, Shtrese asfaltobetoni me granil guri kave, 4cm, me makineri, Shtrese binderi me granil gur kave, 6cm, me makineri, Guardrail- H1 anesore me 2 valze ne 1 ane , E3*”. Në lidhje me zërat e mësipërm të punimeve, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë është paraqitur dokumentacion fatura tatimore, dhe oferta të lëshuara nga subjekte të ndryshme që provojnë kushint favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve, në kuptim të nenit 93 të pika 2 gërma “b” të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar.

III.2.7. Gjithashtu në lidhje me zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi, nga shqyrtimi i relacionit të argumentimit të ofertës anomalisht të ulët, rezulton se nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë për zërat e punimeve “Skarifim shtresë asfalti me makineri”, Mbushje me cakëll pas mureve”, “Pastrim i kanaleve dhe kunetave”, “Pastrim i tombinove ekzistuese rrethore dhe katrore” “Mbushja dhe nivelimi i bankinave”, “Pastrim i vegjetacionit” “Pastrim i karrexhatës nga aluvionet dhe materialet e tjera” “Riparim i gropave të asfaltit” “Mbushje dhe profilim nënshtresave në rrugët me asfalt”, “Mirëmbajtje rutinë e veprave të artit” gjithashtu edhe në punimet e Tabelës A/1, A/2 dhe B” është deklaruar në seksionin e “Punëtorisë”, cmimi për orë pune 367.12 lekë. Në nenin 111, pika 1, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikohet se: “Paga nuk mund të jetë më e ulët se paga minimale e caktuar me vendim të Këshillit të Ministrave”. Në V.K.M nr. 113 datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, parashikohet se: “1. Paga bazë minimale mujore

për punonjësit në shkallë vendi, që është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person, juridik a fizik, vendas ose i huaj, të jetë 40 000 (dyzet mijë) lekë. 2. Paga bazë minimale mujore jepet për 174 orë pune në muaj, të kryera gjatë kohës normale të punës. 3. Paga bazë minimale orare të jetë 229,9 (dyqind e njëzet e nëntë pikë nëntë) lekë. Referuar pikës 3 të VKM nr. 113, datë 1.3.2023 “Për Përcaktimin e Pagës Minimale në Shkallë Vendi”, paga bazë minimale orare është 229.9 lekë, gjithashtu duke zbritur edhe sigurimet shoqërore përkatësisht 9.5% të pagës së tij totale bruto përcaktuar në nenin 10 të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe sigurimet shëndetësore përkatësisht 1.7% referuar nenit 8 të Ligjit nr. 10383, datë 24.02.2011 “Për Sigurimin e Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rezulton se paga minimale neto është 204.15 lekë për orë pune. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se bashkimi i operatorëve ekonomik ankimes, në analizën e cmimeve të paraqitur në procedurën e prokurimit objekt ankimi, ka parashikuar se paga bazë orare për punëtorët është 367.12 lekë/orë, e cila është mbi minimumin ligjor. Komisioni thekson se, respektimi i legjislacionit në fuqi lidhur me pagat e punonjësve nga ana e operatorëve ekonomik, siguron autoritetin kontraktor, jo vetëm për realizimin e punimeve, por edhe për realizimin e tyre sipas standarteve të kërkuara në cilësi dhe volum dhe me çmimin konkures të ofertuar. Përveç sqarimit narrativ, Komisioni konstaton se bashkimi i operatorëve ekonomikë “Ndërtuesi 2014” SHPK & “Varaku E” SHPK në mbështetje të deklarimeve më sipër me qëllim argumentimin e ofertës anomalisht të ulët ka përcaktuar përmes një tablele një analizë për mallin, punën, shërbimet objekt-prokurimi, duke detajuar analizën e kostos në trajtë analitike e konkretisht tabelë të përllogaritjes së kostos së shërbimit për kontratën objekt prokurimi. Siç u përmend më lart, përveç argumentimit në formën e një narrative, ku shpjegon çmimin e ofertuar prej tij dhe elementet favorizuese që disponon të shoqëruara me dokumente provuese, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Ndërtuesi 2014” SHPK & “Varaku E” SHPK ka paraqitur edhe analizën e detajuar të kostos në përmbushje të gërmës a) të nenit 93 të LPP-së, ku flitet për anën ekonomikë të metodës së ndërtimit dhe paraqitjes së analizës së kostos për të gjitha elementet, duke përfshirë edhe koston e lëndës së parë, koston e fuqisë punëtore, koston e transportit, kosto administrative, kosto të tjera . Pra, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Ndërtuesi 2014” SHPK & “Varaku E” SHPK, ka detajuar analizën e kostos në trajtë analitike, duke e argumentuar me prova dhe fakte dhe ka justifikuar çmimin e ofertuar për çdo zë. Gjithashtu, bashkimi i operatorëve ekonomikë “Ndërtuesi 2014” SHPK & “Varaku E” SHPK ka argumentuar edhe elemente të tjera favorizuese në përmbushje të kushtit për zgjedhje teknike të favorshme, si eksperiencia e gjatë në treg. Për sa i përket origjinalitetit të mallrave, punëve, shërbimeve bashkimi i operatorëve ekonomikë “Ndërtuesi 2014” SHPK & “Varaku E” SHPK ka paraqitur kualifikimin e stafit me përvojë të gjatë në fushën e objektit të prokurimit. Akoma më tej, Komisioni vëren, se bashkimi i operatorëve ekonomikë “Ndërtuesi 2014” SHPK & “Varaku E” SHPK në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin për argumentimin e ofertës anomalisht të ulët, ka paraqitur edhe fatura tatimore të blerjes. Në këtë kuptim, KPP gjykon, se bashkimi i operatorëve ekonomikë “Ndërtuesi 2014” SHPK & “Varaku E” SHPK ka përmbushur të gjitha kushtet kumulative të parashikuara nga neni 93 i LPP-së, duke argumentuar në mënyrë bindëse të gjitha elementet e ofertës së tij dhe duke analizuar në mënyrë

të detajuar secilin prej tyre. Në rastin konkret KPP gjykon se operatori ekonomik ka përmbushur katër kushtet kumulative Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se një parashikim i tillë gjen mbështetje edhe ne Direktivën 24/2014 KE “Për prokurimin publik”, ku në nenin 69 të saj, parashikohen edhe kushtet për pranimin e ofertës anomalisht të ulët, në kuadër të zhvillimit të procedurave të prokurimit publik. Konkretisht, në nenin 69 të saj parashikohet se: “Kur autoritetet kontraktore vërejnë se ofertat në lidhje me punët, furnizimet ose shërbimet janë anomalisht të ulëta, u kërkojnë operatorëve ekonomikë që të shpjegojnë çmimin ose kostot e propozuara në ofertë. Shpjegimet e përmendura në paragrafin 1, jepen veçanërisht për: (a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit; (b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës; (c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi; (d) pajtueshmërinë me detyrimet e përmendura në nenin 18, paragrafi 2; (e) pajtueshmërinë me detyrimet e përmendura në nenin 71; (f) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

Bazuar në arsyetimin dhe faktet e shtjelluara më lart, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e operatorit ekonomik – oferta e të cilit në zbatim të formulës të përcaktuar në legjislacion ka dalë anomalisht e ulët, janë paraqitur sqarime dhe dokumentacion jo i plotë që të argumentojnë ofertën anomalisht të ulët, duke mos krijuar bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjithë elementët e saj me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme.

III.2.8 Komisioni gjykon, se një ofertë anomalisht e ulët mund të justifikohet ekonomikisht përmes metodës së përzgjedhur, zgjidhjeve teknike të posaçme, kushteve përjashtimisht favorizuese që gëzon ofertuesi apo origjinaliteti i punës së propozuar. Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se nga ana e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Ndërtuesi 2014” SHPK & “Varaku E” SHPK, janë dorëzuar të gjitha dokumentet provuese mbi metodën e ndërtimit të ofertës ekonomike, mbi të cilën edhe operatori ekonomik ka ofertuar në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe ose ndonjë kusht favorizues, origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi; pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës, duke argumentuar plotësisht, se pse kjo ofertë e dalë anomalisht e ulët duhet të pranohet dhe se nuk krijon asnjë rrezik për mosrealizimin me sukses të kontratës. Argumentimi i dhënë nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Ndërtuesi 2014” SHPK & “Varaku E” SHPK, në rastin konkret krijon bindjen, se kjo ofertë është e rregullt në të gjitha elementet e saj, me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme. Akoma më tej, Komisioni sjell në vëmendje faktin, se është detyrim i operatorëve ekonomikë, që në rast të shpalljes fitues, t’i përmbahen zbatimit të kontratës duke ofruar shërbime/punë/mallra me të njëjtën cilësi, të kërkuara në dokumentet e procedurës së prokurimit dhe me të njëjtën ofertë ekonomike të propozuar. Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se në bazë të të detyrimeve që rrjedhin nga LPP, për monitorimin e zbatimit të kontratës, autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe

përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t'u siguruar nëse cilësia e mallit/punës/shërbimit do të jetë e njëjtë me cilësinë dhe specifikimet teknike të premtuara në ofertë dhe të përcaktuara në kontratë. Në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, autoriteti kontraktor zbaton penaltitetet e parashikuara në kontratë, apo detyrimet sipas parashikimeve të lex specialis për prokurimin publik.

Për sa më sipër pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK për procedurën e prokurimit, “Procedurë e kufizuar (Marrëveshje Kuadër) - shërbime publike - mbi kufirin e lartë monetar - prokurim me mjete elektronike”, me REF-10945-06-24-2024, me objekt Loti 2 “Mirëmbajtje me performancë rruga “Koplik - Bogë, Bogë - Theth, Dedaj - Razëm” (gjatësia totale 67.3 km)”, me fond limit totale 329,552,917 (treqind e njëzet e nëntë milion e pesëqind e pesëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e shtatëmbëdhjetë) Lekë pa TVSH në Euro: 3,286,983.01 (tre milion e dyqind e tetëdhjetë gjashtë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e tre pikë zero një) Euro pa TVSH, zhvilluar më datë 29.07.2024, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësim të procedurës së prokurimit objekt ankimi, në përputhje me konstatimet e këtij vendimi.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Rroku Guest” SHPK & “Deha 2010” SHPK.

5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.

6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri

